FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 9	2001	Mars

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr.8743 datë 22.2.2001	Për pronat e paluajtshme të shtetit……	255
Ligj nr.8744 datë 22.2.2001	Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore……	259
Ligj nr. 8747 datë 28.2.2001	Për ratifikimin e "Marrëveshjes së kredisë të zhvillimit për projektin e lehtësimit të transportit dhe të tregtisë në rajonin e Europës Juglindore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA)"……	266
Ligj nr.8748 datë 1.3.2001	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Panhellenic Exporters Association për konsolidimin e borxhit të jashtëm të Shqipërisë"……	280
Dekret nr.2907 datë 21.2.2001	Për dhënie të shtetësisë shqiptare ……	282
Dekret nr.2914 datë 6.3.2001	Për lënie të shtetësisë shqiptare ……	283

Vendim i KM Nr.27, datë 20.1.2001	Për vendosjen e kutive postare në ndërtesa banimi dhe në institucione ……	284
Vendim i KM Nr.31, datë 20.1.2001	Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik……	285
Vendim i KM Nr.54, datë 2.2.2001	Për kalimin e objekteve kulturore të ish-ndërmarrjeve bujqësore, në pronësi të organeve të qeverisjes vendore..	286
Vendim i KM Nr.55, datë 2.2.2001	Për organizimin e strukturës së zyrave të gjendjes civile..	286
Vendim i KM Nr.56, datë 2.2.2001	Për miratimin e strukturës së çmimeve të barnave, të përfshira në listën e barnave të rimbursuara, me vendimin nr.610, datë 17.11.2000, të Këshillit të Ministrave……	287
Vendim i KM Nr.57, datë 2.2.2001	Për miratimin e strategjisë afatmesme dhe të planit të veprimit, për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme……	289
Vendim i KM Nr.59, datë 2.2.2001	Për disa ndryshime në vendimin nr.364, datë 14.7.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin e punonjësve që shkurtohen nga zbatimi i marrëveshjes së koncesionit për Uzinën e Ferrokromit, Elbasan dhe minierat e kromit, Përrenjas dhe Pojskë……	290
Vendim i KM Nr.63, datë 26.1.2001	Për procedurat e kërkimit, të shqyrtimit dhe të dhënies së autorizimeve, të lejeve dhe koncesioneve për përdorimin e rezervave ujore ……	290
Vendim i KM nr.69, datë 15.2.2001	Për disa ndryshime në vendimin nr.321, datë 5.7.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e shpërndarjes së fondeve, sipas rretheve, procedurat e miratimit të familjeve që përfitojnë dhe kushtet e dhënies së kredisë, në kuadrin e kredisë greke për strehim"……	294
Vendim i KM nr.70, datë 15.2.2001	Për statusin e spitaleve universitare……	294
Vendim i KM nr.72, datë 15.2.2001	Për miratimin e rregullores së produkteve për mbrojtjen e bimëve……	295
Udhëzim i KM Nr.3, datë 15.2.2001	Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit	296
Urdhër i KM Nr.15, datë 9.2.2001	Për kategorizimin e disa bashkive, për efekt page……..	300
Udhëzim i KQZ Nr.18 datë 11.03.2001	Për mënyrën e plotësimit të formularëve që do të përdoren për rishikimin e listave "a" të zgjedhjeve të tetorit 2000, në zyrat e gjendjes civile……	301
	Ndreqje gabimesh……	303

L I G J
Nr.8743, datë 22.2.2001

PËR PRONAT E PALUAJTSHME TË SHTETIT

Në mbështetje të neneve 41, 78, 83 pika 1 dhe 113 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj përcakton regjimin juridik të llojeve të pronave të paluajtshme të shtetit dhe përgjegjësitë për administrimin e tyre.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllimet e këtij ligji, përkufizimet e mëposhtme kanë këto kuptime:

a)"Pronë e paluajtshme e shtetit" kuptohet prona e paluajtshme e pushtetit qendror dhe e njësive të qeverisjes vendore.

b) "Pronë e paluajtshme publike" kuptohet ajo pjesë e pronave të paluajtshme të shtetit që përmbush funksione themelore dhe të pandashme të shtetit dhe që sjell përfitime në favor të publikut të gjerë.

c) "Inventar i pronave të paluajtshme të shtetit" kuptohet dokumenti ku regjistrohen papaprakisht të gjitha pronat e paluajtshme të shtetit gjatë procesit të identifikimit dhe transferimit të tyre. Në vijim do të quhet "inventari".

KREU II
PËRCAKTIMI I PRONAVE TË SHTETIT

Neni 3
Prona publike

1. I përkasin shtetit dhe bëjnë pjesë në pronat e paluajtshme publike:

a) Vija bregdetare për të hyrë në tokë, ujërat territoriale, shtretërit dhe brigjet e lumenjve, të përrenjve a rrjedhave të tjera ujore, liqeneve, lagunave dhe rezervuarëve natyrorë ose artificialë, ishujt dhe grumbullimet e rërës, të gurëve dhe dherave në shtretër të lumenjve, të liqeneve e rezervuarëve, ashtu siç është përcaktuar sipas ligjeve në fuqi.

b) Zonat historike, arkeologjike dhe kulturore, si dhe parqet me rëndësi kombëtare ose vendore.

c) Zonat, instalimet dhe objekte të tjera të destinuara për qëllime të mbrojtjes kombëtare, të rendit dhe sigurisë publike.

ç) Burimet natyrore dhe rezervat minerare e inertet, ashtu siç përcaktohen në legjislacionin në fuqi.

2. Janë, gjithashtu, prona të paluajtshme publike, nëse i përkasin shtetit, edhe pyjet, kullotat dhe livadhet, si dhe çdo lloj tjetër prone e paluajtshme e ndërtuar mbi to, që i shërben drejtpërdrejt mbrojtjes dhe zhvillimit të tyre.

3. Janë, gjithashtu, prona të paluajtshme publike, nëse i përkasin shtetit, edhe aktivet e ngurtësuara (ose të trupëzuara), që shërbejnë për kryerjen e shërbimeve publike si:

- rrugët dhe urat, hekurudhat dhe sistemet ndihmëse të lidhura më to;
- infrastruktura aeroportuale;
- sistemet e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë;
- sistemet e shërbimit të telekomunikacionit dhe të postës;
- sistemet e funizimit me ujë të pijshëm, si dhe të derdhjeve të ujërave të zeza të qendrave të banuara;
- ndërtimet me interes të njohur historik, arkeologjik dhe kulturor;
- parqet, lulishtet, sheshet publike në qytete e qendra të banuara, ndërtesat së bashku me oborret që përdoren për shërbime që ofrohen nga shteti për arsimin, shkencën, kulturën dhe sportet, për shërbimin shëndetësor e shoqëror, për institucionet qendrore dhe vendore, si dhe rezidencat qeveritare së bashku me trojet mbi të cilat ngrihen këto prona.

4. Pronat e paluajtshme publike tjetërsohen ose jepen në përdorim sipas mënyrave dhe kufijve të përcaktuar me ligje të veçanta.

Neni 4

Prona jopublike të paluajtshme të shtetit

1. Prona të paluajtshme të shtetit, që nuk janë pronë publike si toka bujqësore, troje, ndërtesa, aktive të ngurtësuara të ndërmarrjeve nën administrimin e shtetit, si dhe prona të tjera të këtij lloji, nëse nuk i nënshtrohen dispozitave ligjore të posaçme, kanë regjim juridik të barabartë me pronën private dhe i nënshtrohen rregullave të parashikuara në Kodin Civil.

2. Ndryshimi i statusit të një prone të paluajtshme të shtetit nga publike në jopublike bëhet sipas procedurave të përcaktuara me ligj.

Neni 5

Fitimi i mëvonshëm i pronësisë mbi pronat e paluajtshme

Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, shteti mund të fitojë të drejta pronësie mbi pronat e paluajtshme në mënyra të ndryshme si: dhurime, shpronësime, blerje, trashëgimi ose mënyra të tjera të fitimit të të drejtave të pronësisë sipas ligjeve në fuqi.

Neni 6

Regjistrimi i pronave të paluajtshme

1. Të gjitha pronat e paluajtshme të shtetit regjistrohen në Regjistrin e Pronave të Paluajtshme në përputhje me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

2. Regjistrimi i pronave të paluajtshme bëhet përkatësisht:

a) nga Këshilli i Ministrave për pronat në varësi të pushtetit qendror, të cilat regjistrohen me pronar Republikën e Shqipërisë;

b) nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore për pronat e paluajtshme në pronësi të saj, të cilat regjistrohen me pronar njësinë përkatëse të qeverisjes vendore.

Neni 7

Regjistrimi i kushteve dhe i kufizimeve, heqja ose ndryshimi i tyre

1. Në Regjistrin e Pronave të Paluajtshme, për pronat publike të shtetit, do të shënohen edhe:

a) përfitimi publik që vjen nga një pronë ose funksioni themelor, që një pronë e paluajtshme publike përmbush në kuptimin e nenit 2 shkronja b dhe nenit 3 të këtij ligji;

b) kufizimet e përdorimit të pronës së paluajtshme, përfshirë mosndryshimet e destinacionit, me qëllim ruajtjen e karakteristikave të saj dhe mirëmbajtjen;

c) kushtet e së drejtës të përdorimit publik të pronës;

ç) kushtet e garantimit të realizimit të funksioneve që ajo përmbush.

2. Përcaktimet dhe kufizimet e shënuara në Regjistrin e Pronave të Paluajtshme, në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, mund të hiqen ose të ndryshohen me vendim të Këshillit të Ministrave për pronat e paluajtshme të pushtetit qendror në këto raste:

a) kur karakteristikat e shënuara në Regjistrin e Pronave të Paluajtshme nuk përputhen me kriteret e përcaktuara në nenin 2 pika b dhe në nenin 3 të këtij ligji;

b) kur kufizimi i shënuar në Regjistër është më tepër pengues se i nevojshëm;

c) kur gjendja e pronës ka ndryshuar ose rrethanat që kanë justifikuar vendosjen e kufizimeve nuk ekzistojnë më.

KREU III
PËRCAKTIMI I PRONËSISË SË SHTETIT MBI PASURITË E PALUAJTSHME

Neni 8
Përcaktimi i pronësisë

1. Jo më vonë se 90 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Këshilli i Ministrave do të miratojë aktet nënligjore për procedurat, nëpërmjet të cilave do të inventarizohen të drejtat e pronësisë dhe interesat e tjerë, të lidhura me pronën e paluajtshme të shtetit shqiptar.

2. Brenda afateve të përcaktuara nga aktet nënligjore, çdo organ shtetëror dhe njësi e qeverisjes vendore do të hartojë një listë të pronave të paluajtshme, mbi të cilat ai ka përgjegjësi administrative.

3. Brenda një afati të caktuar, por jo më vonë se 12 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave miraton listën e inventarit të pronave të paluajtshme.

Neni 9
Transferimi dhe regjistrimi përfundimtar

Me ligj të veçantë do të përcaktohen pronat e paluajtshme që do të transferohen në pronësi ose përdorim të njësive të qeverisjes vendore, kushtet dhe kufizimet mbi këto të drejta, si dhe procedurat e këtij transferimi.

Neni 10

Këshilli i Ministrave përcakton, për të gjitha pronat e paluajtshme që mbeten në pronësi të pushtetit qendror, përgjegjësitë e administrimit nga organet e ndryshme shtetërore për administrimin e këtyre pronave.

KREU IV
ADMINISTRIMI I PRONËS PRIVATE TË PALUAJTSHME

Neni 11
Administrimi i pronës së paluajtshme

Adminsitrimi i pronës së paluajtshme nga organet shtetërore ose njësitë e qeverisjes vendore bëhet në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe në Kodin Civil.

Neni 12
Parimet e administrimit të pronës së paluajtshme

Administrimi i pronës së paluajtshme siguron këto kushte:

ruajtjen dhe garantimin e interesit publik;

b) ruajtjen e karakteristikave dhe të vlerave unikale të pronës;

ruajtjen dhe rritjen e vlerës ekonomike të pronës;

ç) ruajtjen e treguesve ekologjikë të njësisë së pronës së paluajtshme, sipas parimit të dobishmërisë më të madhe publike.

Neni 13

Këshilli i Ministrave cakton organin shtetëror përgjegjës për administrimin e çdo njësie të pronës së paluajtshme, duke bërë shënimin përkatës në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme.

Neni 14

Këshilli i Ministrave ngarkon me përgjegjësi për administrimin e çdo njësie të pronës së paluajtshme, atë organ shtetëror ose ent publik që ushtron shkallën më të lartë të kontrollit mbi pronën. Në qoftë se asnjë organ nuk plotëson kushtin e mësipërm, Këshilli i Ministrave ngarkon me administrimin e pronës atë organ shtetëror ose ent publik, fusha e veprimtarisë e të cilit është më afër me karakteristikat e pronës.

Neni 15
Ndryshimi i përgjegjësisë së administrimit

Këshilli i Ministrave ndryshon përgjegjësinë e administrimit nga një organ shtetëror ose ent publik te një tjetër në rastet kur:

a) organi përgjegjës nuk administron pronën në përputhje me nenin 13 të këtij ligji;

b) ndryshojnë karakteristikat e pronës;

c) përdorimi më i dobishëm i pronës mund të realizohet nën administrimin e një organi tjetër shtetëror ose publik.

Neni 16

Ndryshimi i përgjegjësisë së organit shtetëror të ngarkuar me administrimin, pasqyrohet me shënimin përkatës në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme.

Neni 17
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve për caktimin e organit shtetëror përgjegjës për administrimin

Nëntëdhjetë ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Këshilli i Ministrave miraton procedurat për kontestimet e mundshme, lidhur me përgjegjësitë e administrimit për pronat e paluajtshme, në përputhje me këtë kre.

Neni 18
Procedurat duhet të garantojnë:

a) zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për emërimin e administratorit të pronës së paluajtshme brenda 90 ditëve nga lindja e tyre;

b) zgjidhja e mosmarrëveshjeve të realizojë kërkesat e caktuara në nenet 3,4 dhe 6 të këtij ligji.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 19

Të gjitha dispozitat ligjore, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 20

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2916, datë 9.3.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr.8744, datë 22.2.2001

PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE TË SHTETIT NË NJËSITË E QEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të neneve 41, 78 dhe 83 pika 1, 111, 112 dhe 113 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj rregullon porcesin e transferimit të pronave të paluajtshme publike të shtetit dhe titujt e pronësisë së shtetit mbi kapitalin e shoqërive tregtare dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore nga pushteti qendror në njësitë e qeverisjes vendore.

Në këtë ligj përcaktohen llojet që do t'u transferohen njësive të qeverisjes vendore, natyra e të drejtave të njësive të qeverisjes vendore mbi to dhe procesi, sipas të cilit do të bëhet transferimi i pronave.

Neni 2
Përcaktimet e termave të përdorura në këtë ligj

a) "Prona" do të quajmë të gjitha pronat e paluajtshme publike të shtetit, si dhe titujt e pronësisë së shtetit mbi kapitalin e shoqërive tregtare dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore.

b) "Transferim" do të quajmë kalimin e të drejtës së pronësisë dhe/ose të drejtën e përdorimit të pronave të paluajtshme publike të shtetit nga pushteti qendror në njësitë e qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

c) "Pushtet qendror" do të quajmë Këshillin e Ministrave, ministritë, si dhe institucionet e tjera që kanë të drejtë të administrojnë pronën e paluajtshme publike të shtetit në përputhje me këtë ligj.

ç) "Kushtet e përdorimit" nënkuptojnë kriteret dhe kufizimet mbi të drejtat e përdorimit të pronave që u transferohen njësive të qeverisjes vendore sipas këtij ligji.

KREU II
LLOJET E PRONAVE QË U TRANSFEROHEN NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE

Neni 3
Prona që u transferohen njësive të qeverisjes vendore

U transferohen njësive të qeverisjes vendore pronat që përdoren për realizimin e funksioneve dhe/ose shërbimeve për bashkësinë të njohura me ligj, të tilla si:

a) Pronat që përdoren për ushtrimin e funksioneve të tyre administrative.

b) Pronat që përdoren për realizimin e programeve arsimore.

c) Pronat që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.

ç) Pronat që përdoren për realizimin e funksioneve ekonomike.

d) Pronat që përdoren për kryerjen e veprimtarive social-kulturore e sportive.

dh) Pronat që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit.

e) Pronat që përdoren për grumbullimin, depozitimin, pastrimin dhe shpërndarjen e ujit, si dhe për grumbullimin, depozitimin, pastrimin dhe shfrytëzimin e mbeturinave dhe ujërave të zeza.

ë) Pronat që përdoren për sistemin e transportit publik.

f) Pronat që përdoren si lehtësira të transportit vendor (urbane, rurale dhe ndërkomunare), përfshirë rrugët, rrugicat, urat, aeroportet dhe portet vendore.

g) Prona të tilla si trotuare, sheshe, rrjeti i ndriçimit publik, si dhe pajisjet e tjera zbukuruese brendapërbrenda bashkive dhe komunave.

gj) Prona të tilla si mjete për funeral, varrezat brendapërbrenda bashkive dhe komunave.

h) Prona të tilla si monumetet historike e kulturore dhe bustet me interes vendor.

i) Prona të tilla si pyje, kullota, parqe dhe kopshte publike, që kanë për qëllim të përdoren për interes vendor.

j) Prona të tilla si struktura dhe njësi rezidenciale me interes vendor.

k) Prona të cilat përdoren për kryerjen e funksioneve të tjera sipas ligjeve në fuqi.

Neni 4
Transferimi i tipeve të tjera të pronës

Kur pronat e paluajtshme shtetërore u transferohen njësive të qeverisjes vendore, çdo pronë e luajtshme, që ka të bëjë me këtë të fundit, duke përfshirë dhe rezervat ligjore, do t'i transferohen, gjithashtu, njësive të qeverisjes vendore.

Së bashku me pronën që transferohet, njësive të qeverisjes vendore, i jepet i gjithë dokumentacioni për këtë pronë.

Në ato raste kur pronat e transferuara njësive të qeverisjes vendore janë në formën e aksioneve në një shoqëri tregtare dhe/ose ndërmarrje shtetërore, pushteti qendror mund të transferojë një pjesë ose të tërë titujt e pronësisë së shtetit mbi kapitalin që ka në këto shoqëri.

KREU III
TË DREJTAT E PRONËSISË, TË PËRDORIMIT DHE KUFIZIMET E TYRE

Neni 5
E drejta e pronësisë dhe e drejta e përdorimit

Transferimi i pronës nga pushteti qendror në njësitë e qeverisjes vendore, sipas këtij ligji bëhet në njërën nga format e mëposhtme:

në pronësi ose

në përdorim

Neni 6

Pushteti qendror për pronat që u transferohen njësive të qeverisjes vendore:

a) në rastin e kalimit të pronës në pronësi njësive të qeverisjes vendore, mbikëqyr respektimin e kushteve dhe/ose të kufizimeve të përcaktura në aktin e transferimit;

b) në rastin e kalimit të pronës në përdorim njësive të qeverisjes vendore, ndërhyn me cilësinë e pronarit, kur vëren mosrespektim të kushteve dhe/ose të kufizimeve të përcaktuara në aktin e transferimit.

Neni 7

Kufizimet mbi të drejtat e pronësisë

Në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë, pushteti qendror mund të vendosë kushte dhe kufizime mbi këtë të drejtë. Këto kushte dhe kufizime duhet të jenë vetëm për të siguruar maksimumin e përfitimeve publike ose mbrojtjen e një karakteristike të veçantë të pronës.

Neni 8

Kufizime mbi të drejtën e pronësisë janë:

a) Mosndryshim i destinacionit. Ndalimi i ndryshimit të destinacionit dhe/ose qëllimit të përcaktuar në aktin e transferimit pa miratimin e pushtetit qendror.

b) Kushte të veçanta përdorimi. Përdorimi i pronës në mënyrë që të garantojë ruajtjen e karakteristikave unikale të saj.

c) Kufizimet mbi të drejtën e tjetërsimit dhe të dhënies në përdorim. Për disa prona mund të ndalohet e drejta e tjetërsimit ose e dhënies në përdorim të të tretëve pa miratimin e pushtetit qendror. Ndalohet tjetërsimi ose ndërrimi i destinacionit të pronave publike, për të legalizuar ndërtime pa leje.

Neni 9

Tjetërsimi ose dhënia në përdorim e pronës së fituar nga transferimi

Njësitë e qeverisjes vendore nuk mund të tjetërsojnë pronën e përfituar (marrë) në pronësi sipas këtij ligji në të gjitha mënyrat e njohura nga legjislacioni në fuqi, ndaj një personi fizik a juridik privat, në njërin nga këto raste:

a) Ka një kusht ose kufizim që i ndalon atij tjetërsimin ose dhënien në përdorim.

b) Prona është e domosdoshme për kryerjen e një funksioni të qeverisjes vendore.

Neni 10

Përdorimi i të ardhurave nga tjetërsimi ose dhënia në përdorim e pronës

Të ardhura nga tjetërsimi ose dhënia në përdorim e pronës duhet të përdoren vetëm për realizimin e funksioneve të njësive të qeverisjes vendore.

Neni 11

Heqja e kushteve ose kufizimeve për pronën

1. Njësitë e qeverisjes vendore mund t'i kërkojnë Këshillit të Ministrave heqjen e një kushti ose të një kufizimi të vendosur sipas këtij ligji për çdo pronë, që ato e kanë në pronësi, vetëm 3 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Këshilli i Ministrave, brenda 90 ditëve pas marrjes së kërkesës, shprehet për pranimin ose mospranimin e saj. Në rast se brenda këtij afati Këshilli i Ministrave nuk shprehet, kërkesa vlerësohet e pranuar.

2. Në rastin e mospranimit të kërkesës nga Këshilli i Ministrave, njësia e qeverisjes vendore ka të drejtë t'ia kthejë pronën në pronësi pushtetit qendror, i cili është i detyruar ta pranojë. Në këtë rast, Këshilli i Ministrave, brenda 6 muajve pas njoftimit nga njësia e qeverisjes vendore, e kundërshpërblen atë për çdo përmirësim që mund t'i ketë bërë pronës me burimet e saj pas transferimit. Në rast të mosshlyerjes së detyrimit brenda afatit nga Këshilli i Ministrave, kushti ose kufizimi hiqet automatikisht.

Neni 12

Kushtet dhe/ose kufizimet e vendosura sipas këtij ligji mbi pronën e transferuar do të kenë fuqi derisa ato të hiqen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

E drejta e njësive të qeverisjes vendore mbi pronat e dhëna në përdorim

1. Kur një njësie të qeverisjes vendore i jepet e drejta e përdorimit për një pronë, Këshilli i Ministrave, në aktin e transferimit, përcakton kushtet e përdorimit të saj.

2. Kushtet e përdorimit të çdo prone respektojnë pavarësinë e njësive të qeverisjes vendore për përmbushjen e funksioneve me të cilat lidhet kjo pronë.

Neni 14

Shfuqizimi i së drejtës së përdorimit të pronës

Këshilli i Ministrave vendos për shfuqizimin e së drejtës të përdorimit të një prone nga njësitë e qeverisjes vendore në këto raste:

a) Kur funksioni i deleguar, për të cilin prona është transferuar, përfundon ose ndërpritet.

b) Në çastin kur Këshilli i Ministrave vëren se prona nuk po përdoret nga njësia e qeverisjes vendore sipas kushteve dhe/ose kufizimeve të përdorimit të pronës në fjalë.

Neni 15

Procedurat e dhënies në përdorim të pronës

Këshilli i Ministrave do të ndjekë procedurën e mëposhtme për përfundimin e dhënies në përdorim sipas neneve 14(a) ose 14 (b):

a) Në rastin kur vendimi, që i heq të drejtën e përdorimit të pronës njësive të qeverisjes, merret sipas nenit 14(a), atëherë vendimi do të ekzekutohet vetëm kur përmbushen dy kushtet e mëposhtme:

- të kenë kaluar 90 ditë nga njoftimi i këtij vendimi njësive të qeverisjes vendore dhe
- vetëm pas shlyerjes së detyrimeve që Këshilli i Ministrave u ka njësive të qeverisjes vendore për përmirësimet e bëra pronës me fondet e veta.

Shlyerja e detyrimit bëhet jo më vonë se 6 muaj nga dita e njoftimit. Nëse pushteti qendror nuk shlyen detyrimet, njësitë e qeverisjes vendore kanë të drejtë ta përdorin pronën deri në shlyerjen e detyrimit për një periudhë trevjeçare.

b) Në rastin kur vendimi, që i heq të drejtën e përdorimit të pronës njësive të qeverisjes vendore, merret sipas nenit 14(b), Këshilli i Ministrave ekzekuton vendimin e tij brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit njësive të qeverisjes vendore, pavarësisht nga shlyerja ose jo e përmirësimeve të bëra pronës nga njësitë e qeverisjes vendore me fondet e veta.

Këshilli i Ministrave do të shlyejë detyrimin për përmirësimet e bëra pronës nga njësitë e qeverisjes vendore jo më vonë se 6 muaj nga data e ekzekutimit të vendimit. Pas 6 muajsh, pushteti qendror paguan një kamatë 1 për qind në ditë të shumës së përgjithshme që u detyrohet njësive të qeverisjes vendore.

Neni 16

Përgjegjësia financiare mbi pronat që transferohen

1. Në rast se Këshilli i Ministrave do të vendosë një kusht, që i shkakton njësive të qeverisjes vendore kosto për mirëmbajtjen ose për përmirësimin e pronës, ai do t'u sigurojë njësive të qeverisjes vendore fonde financiare për përballimin e këtyre shpenzimeve.

2. Sa herë që Këshilli i Ministrave u jep të drejta përdorimi mbi një pronë njësive të qeverisjes vendore, ai do t'u sigurojë atyre mjete të nevojshme për shfrytëzim dhe mirëmbajtjen e kësaj prone.

3. Kushtet e përdorimit shoqërohen me detyrimet përkatëse financiare të njësive të qeverisjes

vendore dhe asaj qendrore për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e pronës.

KREU IV
PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Neni 17
Afatet dhe procedurat e transferimit

Transferimi i pronave, sipas këtij ligji, do të përfundojë brenda 24 muajve pas hyrjes së tij në fuqi. Transferime të tjera do të kryhen edhe pas këtij afati, sa herë që do të ketë shtesa të funksioneve të njësive të qeverisjes vendore.

Kryerja e transferimit do të bëhet si vijon:

a) Jo më parë se afati i përcaktuar në nenin 21 të këtij ligji dhe jo më vonë se 13 muaj nga data e hyrjes në fuqi të tij, njësitë e qeverisjes vendore paraqesin në Këshillin e Ministrave listën e pronave që ato kërkojnë t'u transferohen në përputhje me nenin 4 dhe nenet e kreut III të këtij ligji.

b) Brenda 20 muajve nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave, pasi të shqyrtojë kërkesat e paraqitura nga njësitë e qeverisjes vendore, sipas shkronjës (a) të këtij neni, merr vendim paraprak për listën e pronave që do t'ia transferojë çdo njësie të qeverisjes vendore. Lista e pronave që transferohen përmban kushtet dhe kufizimet që Këshilli i Ministrave vendos për pronat në pajtim me këtë ligj. Lista u njoftohet menjëherë çdo njësie të qeverisjes vendore përkatëse, e cila, brenda 10 ditëve nga dita e njoftimit, e shpall atë publikisht.

c) Jo më vonë se 3 muaj nga data e marrjes së listës së pronave, çdo njësi e qeverisjes vendore mund t'i parashtrojë Këshillit të Ministrave kundërshtime për përmbajtjen e listës, sipas shkaqeve të caktuara në nenin 19 të këtij ligji.

ç) Jo më vonë se 24 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Këshilli i Ministrave do të vendosë përfundimisht për transferimin e pronës për të cilën ka kundërshtime nga njësitë e qeverisjes vendore, së bashku me ndonjë kusht ose kufizim që duhet zbatuar në këto prona.

d) Njësitë e qeverisjes vendore, të cilat fillimisht paraqesin listën e pronës sipas nenit 17(a), mund ta kundërshtojnë vendimin përfundimtar të Këshillit të Ministrave para gjykatës së rrethit gjyqësor (seksioni administrativ), sipas nenit 19 të këtij ligji.

dh) Njësitë e qeverisjes vendore, të cilat nuk e parashtrojnë listën e pronave sipas nenit 17(a), nuk kanë të drejtë të kundërshtojnë vendimin përfundimtar të Këshillit të Ministrave për transferimin e pronave.

Neni 18
Dokumentacioni i transferimit

Të gjitha pronat, të cilat u kalohen në pronësi njësive të qeverisjes vendore sipas këtij ligji, do të regjistrohen në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me pronar njësinë përkatëse të qeverisjes vendore, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Po kështu do të regjistrohen në kartelën e pasurisë së paluajtshme edhe kushtet dhe kufizimet e vendosura sipas këtij ligji.

KREU V
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 19

1. Çdo njësi e qeverisjes vendore ka të drejtë të kundërshtojë listën e pronës së përgatitur nga Këshilli i Ministrave sipas nenit 17(c) të këtij ligji, për shkaqet e mëposhtme:

a) Njësive të qeverisjes vendore u mungon aftësia financiare për mirëmbajtjen e pronave.

b) Njësitë e qeverisjes vendore mendojnë se prona nuk është e nevojshme për kryerjen e një funksioni të tyre.

c) Njësitë e qeverisjes vendore mendojnë se një pronë duhet t'i shtohet listës për përmbushjen

e funksioneve të tyre në përputhje me nenin 3 dhe kreun III të këtij ligji.

ç) Njësitë e qeverisjes vendore besojnë se një kusht ose kufizim, që rekomandohet për t'u vendosur mbi një pronë, nuk është në përputhje me parimet e caktuara në nenet 4, 5, 6, 7 dhe 8 të këtij ligji.

2. Nëse bisedimet për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe njësisë së qeverisjes vendore përkatëse nuk e zgjidhin atë brenda kohës së përcaktuar në nenin 17(ç), atëherë brenda 6 muajve palët kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës së rrethit gjyqësor (seksioni administrativ).

3. Për mosmarrëveshjet që lidhen me përmbushjen e detyrimeve financiare, të parashikuara në nenin 16 të këtij ligji, si dhe në dokumentacionet e transferimit, palët kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës së rrethit gjyqësor (seksioni administrativ).

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 20

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ndërtesat administrative të bashkive dhe komunave dhe të gjitha mjediset në të cilat ushtrojnë veprimtaritë e tyre administratat vendore, që janë nën administrimin e njësive të qeverisjes vendore dhe kur nuk përbëjnë konflikt pronësie me të tretë, kalojnë në pronësi të komunave ose bashkive.

Komunat dhe bashkitë, me miratimin e këshillave komunale, marrin masa dhe mbulojnë koston për regjistrimin e këtyre pronave sipas procedurave të përcaktuara me ligjin përkatës.

Neni 21
Organi përgjegjës për zbatimin e ligjit

Këshilli i Ministrave, brenda 3 muajve pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e tij dhe ngarkon strukturat përkatëse për zbatimin e tij.

Aktet nënligjore do të përfshijnë edhe formularët standard të propozimit dhe të transferimit të pronës.

Nen 22

Dispozitat ligjore, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 23

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2917, datë 9.3.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr. 8747, datë 28.2.2001

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË KREDISË TË ZHVILLIMIT PËR PROJEKTIN E LEHTËSIMIT TË TRANSPORTIT DHE TË TREGTISË NË RAJONIN E EUROPËS JUGLINDORE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA)"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të

Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e kredisë së zhvillimit për projektin e lehtësimit të transportit dhe të tregtisë në rajonin e Europës Juglindore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA)".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2919, datë 9.3.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Numri i Kredisë 3427 ALB

MARRËVESHJA
E KREDISË SË ZHVILLIMIT (PROJEKTI I LEHTËSIMIT TË TREGTISË DHE TRANSPORTIT NË EUROPËN JUGLINDORE) MIDIS REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM DATË, NËNTOR 29, 2000

MARRËVESHJA E KREDISË SË ZHVILLIMIT

MARRËVESHJA e datës 29 Nëntor 2000 midis REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (Huamarrësi) dhe SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (Shoqata)

Ndërsa (A), Shoqata ka hyrë në një Memorandum Mirëkuptimi (MM) në 10 shkurt 2000 me Vende të tjera të Rajonit (siç do të përcaktohen më pas) që afirmon angazhimin e Vendeve të Rajonit për një program që ka si synim lehtësimin e tregtisë dhe transportit (Programi Rajonal);

Ndërsa (B), Huamarrësi, pasi ka mbetur i kënaqur me zbatueshmërinë dhe prioritetin e Projektit që përshkruhet në Seksionin 2 të kësaj Marrëveshjeje i ka kërkuar Shoqatës ta ndihmojë në financimin e këtij Projekti;

Ndërsa (C), të ndihmojë në financimin e Projektit dhe masave të tjera të përfshira në Programin Rajonal, Huamarrësi synon të sigurojë asistencë financiare nga burime të jashtme në një shumë të barabartë me 1,300,000 dollarë; dhe

Ndërsa Shoqata midis të tjerash ka rënë dakord mbi bazën e sa më sipër t'i japë një Kredi Huamarrësit mbi bazën e afateve kohore dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje;

Në BAZË TË SA MË SIPËR, palët e mësipërme bien dakord për sa më poshtë:

Neni 1
Kushtet e Përgjithshme; Përkufizimet

Seksioni 1.01. "Kushtet e Përgjithshme të Marrëveshjeve të Kredisë së Zhvillimit" të Shoqatës të datës 1 Janar, 1985 (siç janë ndryshuar deri më 6 tetor 1999) me modifikimet e mëposhtme (Kushtet e Përgjithshme) përbëjnë një pjesë të pandarë të kësaj Marrëveshjeje.

(a) Një paragraf i ri (12) i shtohet Seksionit 2.01 me përmbajtjen e mëposhtme dhe për pasojë paragrafet ekzistuese (12) deri në (14) të këtij Seksioni do t'u vendosen numra të rinj dhe do të bëhen

paragrafet (13) deri në (15):

"12. Vendi Pjesëmarrës do të thotë çdo vend që për Shoqatën përmbush kushtet e përcaktuara në Seksionin 11 të Rezolutës Nr.194 të Bordit të Guvernatorëve të Shoqatës, aprovuar më 8 prill 1999; dhe "Vendet Pjesëmarrëse" do të quhen me një emër (së bashku) të gjitha këto vende"; dhe

(b) Fjalia e dytë e Seksionit 5.01 është ndryshuar me përmbajtjen e mëposhtme:

"Me përjashtim të rasteve kur Huamarrësi dhe Shoqata bien dakord për ndryshe, nuk do të bëhet asnjë tërheqje: (a) për shpenzime në territorin e një vendi që nuk është Vend Pjesëmarrës apo për mallra të prodhuara dhe shërbime të siguruara nga këto territore; ose (b) për qëllime pagesash të çfarëdolloji kundrejt personave apo njësive, apo për import mallrash, në rast se kjo pagesë apo ky import, me sa është në dijeni Shoqata, është e ndaluar me një vendim të Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Seksioni 1.02. Vetëm në ato raste kur kërkohet ndryshe nga konteksti, afatet e përcaktuara në Kushtet e Përgjithshme dhe në Hyrjen e kësaj Marrëveshjeje kanë kuptimet përkatëse të përcaktuara më poshtë:

(a)"Strategjia e Reformës për Doganat" ka kuptimin e strategjisë të kënaqshme për Shoqatën, të miratuar nga Huamarrësi, ku përshkruhen masat që do të ndërmerren gjatë periudhës së zbatimit të projektit për forcimin e DPD-së:

(b)"Plani i Menaxhimit të Mjedisit" ka kuptimin e planit të kënaqshëm për Shoqatën, të përgatitur dhe miratuar nga Huamarrësi, ku përshkruhen masat për monitorimin e mjedisit si edhe masat institucionale në kuadrin e Projektit;

(c)"DPD" do të thotë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, një agjenci e Huamarrësit që është në varësinë e MF-së;

(d)"DPR" do të thotë Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, një agjenci e Huamarrësit që është nën varësinë e Ministrisë së Transporteve;

(e)"ICIS" është sistemi i integruar i informacionit doganor i DPD-së që do të mbështetet sipas Pjesës C të Projektit;

(f)"MF" është Ministria e Financës të Huamarrësit;

(g)"Vend i Rajonit" është çdo vend pjesëmarrës në Programin Rajonal;

(h)"PIP" është Plani i Zbatimit të Projektit i miratuar nga Huamarrësi; ky Plan përfshin Strategjinë e Reformës në Dogana dhe Planin e Menaxhimit të Mjedisit, si edhe përcakton masat që kërkohen për zbatimin e Projektit;

(i)"PIT" është Ekipi i Zbatimit të Projektit që është ngritur brenda Ministrisë së Financës dhe që vepron nën Menaxheren e Projektit;

(j)"Koordinatori i Projektit" është Koordinatori i Projektit i ngarkuar/caktuar nga Huamarrësi; Koordinatori i Projektit është përgjegjës për koordinimin e veprimtarive të agjencive të Huamrrësit, në kontekstin e Projektit;

(l)"Raporti mbi Menaxhimin e Projektit" është çdo raport i përgatitur në përputhje me Seksionin 4.02 të kësaj Marrëveshjeje;

(k)"Menaxher Projekti" është drejtuesi i PIT-it;

(m)"Avanca për Përgatitjen e Projektit" është Avanca për Përgatitjen e Projektit që i jepet Huamarrësit nga Shoqata sipas një letër shkëmbimi të datës 25 maj 2000 dhe 13 qershor 2000 midis Huamarrësit dhe Shoqatës;

(n)"KDR" është Komiteti Drejtues Rajonal i krijuar nga Vendet Pjesëmarrëse sipas Memorandumit të Mirëkuptimit me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të Programit Rajonal;

(o)"Llogaria e Veçantë" është llogaria të cilës i referohet Pjesa B e Shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje; dhe

(p)"Koordinatori i Website-it" është Koordinatori i Website-it i caktuar nga DPD-ja për qëllimet e Projektit.

Neni 2

Kredia

Seksioni 2.01Shoqata bie dakord t'i huajë Huamarrësit, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara apo të referuara në Marrëveshjen e Kredisë së Zhvillimit, një shumë në monedha të

ndryshme të barabarta me gjashtë milion e dyqind mijë Të Drejta Speciale Tërheqjeje (SDR 6,200,000).

Seksioni 2.02 (a) Shuma e Kredisë mund të tërhiqet nga Llogaria e Kredisë në përputhje me dispozitat e Shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje për shpenzimet e bëra (ose për shpenzimet që do të bëhen në rast se bie dakord Shoqata) në lidhje me kosto të arsyeshme mallrash dhe shërbimesh që kërkohen për Projektin, dhe që do të financohen nga Kredia.

(b) Menjëherë pas Datës së Hyrjes në fuqi, Shoqata në emër të Huamarrësit do të tërheqë nga Llogaria e Kredisë dhe do të vetë-paguhet për shumën që kërkohet për të shlyer shumën e principalit të Avancës së Përgatitjes të Projektit që është tërhequr dhe ka mbetur pa paguar deri më atë datë, si edhe do të paguajë të gjitha tarifat e tjera. Pjesa që ka mbetur e pa tërhequr e shumës të autorizuar nga Avanca e Përgatitjes së Projektit do të anullohet.

Seksioni 2.03 Data e Mbylljes do të jetë 30 Qershor 2004 apo ndonjë datë e mëvonshme që do të përcaktohet nga Shoqata. Shoqata do të njoftojë menjëherë Huamarrësin për këtë datë të mëvonshme.

Seksioni 2.04 (a) Huamarrësi do t'i bëjë Shoqatës një pagesë të detyruar mbi shumën kryesore të Kredisë që nuk është tërhequr herë pas here në një shumë që do të përcaktohet nga Shoqata më datë 30 qershor të çdo viti, por që nuk duhet të kalojë gjysëm për qind (1/2 e 1%) për vit.

(b) Shuma e detyruar do të rritet; (i) pas gjashtëdhjetë ditëve nga data e kësaj Marrëveshjeje (data e interesit) deri në datat respektive në të cilat do të tërhiqen ose anullohen nga Huamarrësi shumat nga Llogaria e Kredisë; dhe (ii) në shumën e caktuar në 30 Qershor menjëherë përpara datës së interesit dhe me shuma të tjera siç mund të caktohen herë pas here në bazë të paragrafit (a) më sipër. Shuma e caktuar më datë 30 Qershor të çdo viti do të zbatohet që nga data tjetër e atij viti, datë kjo e përcaktuar në Seksionin 2.06 të kësaj Marrëveshjeje.

(c) Shuma e detyruar do të paguhet: (i) në vende të tilla që kërkon Shoqata brenda arsyes; (ii) pa kufizime të çdo lloji të vendosura në territorin e Huamarrësit; dhe (iii) në monedhën e specifikuar në këtë Marrëveshje për qëllimet e Seksionit 4.02 të Kushteve të Përgjithshme apo në ndonjë monedhë apo monedha të tjera të përshtatshme që mund të caktohen ose përzgjidhen herë pas here në bazë të dispozitave të atij Seksioni.

Seksioni 2.05 Huamarrësi duhet t'i paguajë Shoqatës një tarifë shërbimi prej tre të katërtave në një për qind (3/4 e 1%) në vit mbi shumën principale të Kredisë së tërhequr dhe të papaguar nga koha në kohë.

Seksioni 2.06 Shumat e detyrueshme dhe ato të shërbimit do të jenë të pagueshme çdo gjashtë muaj më 15 Qershor dhe 15 Dhjetor të çdo viti.

Seksioni 2.07 (a) Në bazë të paragrafeve (b), (c) dhe (d) më poshtë, Huamarrësi do të paguajë shumën principale të Kredisë me këste gjashtë mujore të pagueshme në çdo 15 Qershor dhe 15 Dhjetor duke filluar nga 15 Dhjetor, 2010 dhe duke përfunduar në 15 Qershor 2040. Çdo këst, duke përfshirë këstin e pagueshëm më 15 Qershor 2020, do të jetë një për qind (1%) e kësaj shume principale dhe çdo këst i mëvonshëm do të jetë dy për qind (2%) i kësaj shume principale.

(b) Kur (i) prodhimi i përgjithshëm kombëtar për frymë (GNP-ja) e Huamarrësit, siç është vendosur nga Shoqata, do të ketë kaluar për tre vjet rresht një pas një nivelin e përcaktuar për vit nga Shoqata për përcaktimin e eligibilitetit të pranimit në burimet e Shoqatës; dhe (ii) Banka do t'a konsiderojë Huamarrësin të vlefshëm për t'i dhënë kredi, Shoqata mundet që pas rishikimit dhe aprovimit nga Drejtorët Ekzekutivë të Shoqatës dhe pas një periudhe konsiderimi nga ana e tyre të zhvillimit të ekonomisë të Huamarrësit, të modifikojë pagesën e kësteve në bazë të paragrafit (a) më sipër duke:

(A) i kërkuar Huamarrësit të shlyejë dyfishin e shumës të secilit prej këtyre kësteve që nuk janë bërë ende për t'u paguar deri kur të paguhet shuma principale e Kreditit; dhe

(B) i kërkuar Huamarrësit të fillojë pagesën e shumës principale të Kredisë që nga data e parë e pagesës gjysëm vjetore për të cilën bëhet fjalë në paragrafin (a) më sipër, pas gjashtë apo më shumë muajsh pas datës në të cilën Shoqata njofton Huamarrësin që ngjarjet e përcaktuara në paragrafin (b) kanë ndodhur, duke pasur parasysh që do të ketë një periudhë falleje prej një minimumi pesë vjetësh mbi këtë shlyerje të principalit.

(c) Nëse kërkohet nga Huamarrësi, Shoqata mund të rishikojë modifikimet e referuara në paragrafin (b) më sipër që do të përfshijë disa ose të gjitha rritjet në shumat e kësteve të tilla, pagesën

e interesit në një tarifë vjetore të rënë dakord me Shoqatën mbi shumën principale të Kredisë së tërhequr herë pas here, duke pasur parasysh që në bazë të gjykimit të Shoqatës një rishikim i tillë do të ndryshojë elementin e grantit që është marrë në bazë të modifikimit të mësipërm të shlyerjes.

(d) Nëse në ndonjë moment pas modifikimeve të termave në bazë të paragrafit (b) më sipër, Shoqata vendos që kushti ekonomik i Huamarrësit është përkeqësuar në mënyrë të ndjeshme, në rast se kërkohet nga Huamarrësi, Shoqata mundet të modifikojë më tej termat e pagesës për të qenë konform skedulit të kësteve siç paraqitet në paragrafin (a) më sipër.

Seksioni 2.08 Monedha e Shteteve të Bashkuara të Amerikës specifikohet për qëllimet e Seksionit 4.02 të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 3
Zbatimi i Projektit

Seksioni 3.01 (a) Huamarrësi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të Projektit, të përcaktuara në Shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje. Për këtë qëllim do të zbatojë Projektin me kujdesin/zellin dhe efikasitetin e duhur, si edhe në përputhje me praktikat e përshtatshme financiare, administrative, mjedisore dhe teknike. Huamarrësi do të sigurojë menjëherë, sipas nevojës, fondet, lehtësitë dhe burimet e tjera të kërkuara nga Projekti.

(b) Pa u kufizuar nga dispozitat e paragrafit (a) të këtij Seksioni dhe me përjashtim të atyre rasteve kur Huamarrësi dhe Shoqata bien dakord për ndryshe, Huamarrësi do të zbatojë Projektin në përputhje me Programin e Zbatimit të përcaktuar në Shtojcën 4 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.02 Me përjashtim të atyre rasteve kur Shoqata bie dakord për ndryshe, prokurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve të konsulentëve të nevojitura në kuadrin e Projektit dhe që do të financohen nga Kredia do të qeverisen nga dispozitat e Shtojcës 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.03 Për qëllimet e Seksionit 9.06 të Kushteve të Përgjithshme dhe pa u kufizuar me to, Huamarrësi:

(a) mbi bazën e udhëzimeve të pranueshme për Shoqatën, do të përgatisë dhe do t'i paraqesë Shoqatës një plan për funksionimin e ardhshëm të Projektit jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas Datës së Mbylljes apo ndonjë date tjetër për të cilën mund të jetë rënë dakord midis Huamarrësit dhe Shoqatës, dhe

(b) t'i japë Shoqatës mundësinë për të shkëmbyer mendime mbi këtë plan të Huamarrësit.

Neni 4
Klauzolat financiare

Seksioni 4.01 (a) Huamarrësi do të krijojë dhe mbajë edhe më vonë gjatë gjithë kohës një sistem të menaxhimit financiar, duke përfshirë regjistrat dhe llogaritë dhe do të përgatisë deklaratat financiare në një format të pranueshëm për Shoqatën, i përshtatshëm për të reflektuar veprimtaritë, burimet dhe shpenzimet e lidhura me Projektin.

(b) Huamarrësi:

(i) do të mbajë regjistrat, llogaritë dhe deklaratat financiare të cilave u referohet paragrafi (a) i këtij Seksioni, si edhe regjistrat dhe llogaritë për Llogarinë e Veçantë për çdo vit fiskal të audituar në përputhje me standardet e kontroll-revizionimit të pranueshme nga Shoqatat, të aplikuara në mënyrë të qendrueshme nga revizorë të pavarur të pranueshëm nga Shoqata;

(ii) do t'i paraqesë/dorëzojë Shoqatës (A) kopje të vërtetuara të deklaratave financiare që u referohet paragrafi (a) i këtij Seksioni për çdo vit kontroll-revizioni dhe (B) një opinion mbi këto deklarata, regjistra dhe raporte të kontroll-revizionit nga këta revizorë sipas detajeve të kërkuara, brenda arsyes nga Shoqata, sapo këto të jenë gati, por sidoqoftë jo më vonë se pas gjashtë muajsh nga data e përfundimit të çdo viti të tillë; dhe

(iii) do t'i paraqesë Shoqatës çfarëdo lloj informacioni tjetër në lidhje me këto regjistra dhe llogari si edhe me revizionimin e tyre, si edhe informacion në lidhje me revizorët sa herë që Shoqata ta kërkojë një gjë të tillë.

(c) Për të gjitha shpenzimet në lidhje me tërheqjet nga Llogaria e Kredisë në bazë të deklaratës së shpenzimeve, Huamarësi:

(i) do t'i mbajë apo do të shkaktojë mbajtjen e regjistrave dhe llogarive të veçanta që tregojnë këto shpenzime në përputhje me paragafin (a) të këtij Seksioni;

(ii) do t'i ruajë për së paku një vit pasi Shoqata të ketë marrë raportin e kontroll-revizionit për vitin fiskal në të cilin është bërë tërheqja e fundit nga Llogaria e Kredisë të gjitha regjistrat (kontratat, urdhrat, faturat dhe dokumentet e tjera) që vërtetojnë këto shpenzime;

(iii) do t'i vërë këto regjistra në dispozicion të përfaqësuesit të Shoqatës për shqyrtim; dhe

(iv) do të sigurohet që këto regjistra dhe llogari të përfshihen në kontroll-revizionin vjetor të cilit i referohet paragarafi (b) i këtij Seksioni dhe që raporti i këtij kontroll-revizioni të përmbajë një opinion të veçantë nga këta revizorë nëse deklaratat e shpenzimeve gjatë vitit fiskal në fjalë së bashku me procedurat dhe kontrollet e brendshme që janë bërë gjatë përgatitjes së tyre të jenë të besueshme për të mbështetur tërheqjet në fjalë.

Seksioni 4.02 (a) Pa i kufizuar në dispozitat e Seksionit 4.01 të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do të zbatojë një plan veprimesh me afate kohore që të jetë i pranueshëm për Shoqatën me synim fuqizimin e sistemit të menaxhimit financiar që iu referuam në paragrafin (a) të Seksionit 4.01 në fjalë, me qëllim që Huamarrësi jo më vonë se 31 Dhjetor, 2000, apo në atë datë të mëvonshme për të cilën do të bjerë dakord Shoqata për të përgatitur raporte tremujore, të pranueshëm për Shoqatën, mbi menaxhimin e Projektit. Secili nga këta raporte:

(i) (A) përcakton burimet faktike dhe aplikimet për fondet e Projektit, si në mënyrë kumulative dhe për periudhën e mbuluar nga raporti në fjalë, si edhe burimet e parashikuara dhe aplikimet për fonde nga Projekti për periudhën gjashtë mujore pas periudhës të mbuluar nga raporti në fjalë, dhe (B) të tregojnë në veçanti shpenzimet e financuara nga Kredia gjatë periudhës që mbulon raporti në fjalë dhe shpenzimet e propozuara për t'u financuar nga Kredia gjatë gjashtë muajve pas periudhës të mbuluar nga raporti në fjalë;

(ii)(A) përshkruan ecurinë fizike në zbatimin e Projektit, si në mënyrë kumulative, ashtu edhe për periudhën që mbulon raporti në fjalë, dhe (B) shpjegon ndryshimet/mospërputhjet midis synimeve faktike dhe atyre të parashikuara për zbatim; dhe

(iii)përcakton statusin e prokurimeve në kuadrin e Projektit dhe të shpenzimeve sipas kontratave të financuara nga Kredia në fund të periudhës të mbuluar nga raporti në fjalë.

(b) Me përfundimin e planit të veprimeve, të përmendur në paragrafin (a) të këtij Seksioni, Huamarrësi në përputhje me udhëzime të pranueshme nga Shoqata do të përgatisë dhe paraqesë Shoqatës jo më vonë se 45 ditë pas fundit kalendarik të çdo tremujori një Raport mbi Menaxhimin e Projektit për periudhën në fjalë.

Neni 5
Mjetet ligjore të Shoqatës

Seksioni 5.01. Në bazë të Seksionit 6.02 (1) të Kushteve të Përgjithshme, specifikohet ngjarja tjetër e mëposhtme, d.m.th. që Memorandumi i Mirëkuptimit do të ndryshohet, pezullohet, shfuqizohet, përfundohet, hiqet apo modifikohet, në mënyrë që të ndikojë materialisht dhe në mënyrë kontradiktore aftësinë e Huamarrësit për të kryer detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 5.02. Sipas Seksionit 7.01 (h) të Kushteve të Përgjithshme, specifikohet ngjarja e mëposhtme shtesë, d.m.th. që ngjarja e specifikuar në Seksionin 5.01 të kësaj Marrëveshjeje do të ndodhë dhe do të vazhdojë për një periudhë 60 ditore pasi të jetë njoftuar Huamarrësi nga Shoqata.

Neni 6
Data e hyrjes në fuqi; Përfundimi

Seksioni 6.01 Ngjarja e mëposhtme specifikohet si kusht shtesë për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Kredisë së Zhvillimit brenda kuptimit të Seksionit 12.01 (b) të Kushteve të Përgjithshme:

(a) të jetë krijuar PIT me personelin (duke përfshirë Menaxherin e Projektit, specialistin për prokurimet, llogaritarin dhe pjesa tjetër administrative e personelit), funksionet dhe termat e referencës të kënaqshme për Shoqatën, si edhe me burimet dhe sistemin e menaxhimit financiar të kënaqshëm për Shoqatën.

Seksioni 6.02. Data nëntëdhjetë (90) ditë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje është specifikuar këtu më poshtë për qëllimet e Seksionit 12.04 të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 7
Përfaqësuesi i Huamarrësit; Adresat

Seksioni 7.01. Ministri i Financave i Huamarrësit është caktuar si përfaqësues i Huamarrësit për qëllimet e Seksionit 11.03 të Kushteve të Përgjithshme.

Seksioni 7.02. Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllimet e Seksionit 11.01 të Kushteve të Përgjithshme.

Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë
Shqipëri
Fax: 355 42 284 94
Për Shoqatën:
International Development Association
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America
Adresa cableTeleks
INDEVAS248423 (MCI) ose
Washington, D.C.64145 (MCI)
Fax: (202)477-6391

NË PRANI TË DËSHMITARËVE, palët e mësipërme, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar, kanë firmosur në emrat e tyre përkatës në Distriktin e Kolumbias në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sipas ditës dhe vitit që është shkruar më sipër.

SHQIPËRI
NgaPërfaqësuesi i Autorizuar
Petrit Bushati
Ambasador në SHBA
SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM
NgaZëvendës Presidenti Rajonal
Europa dhe Azia Qendrore
Shtojca 1
Tërheqjet nga Kredia

A. TË PËRGJITHSHME

1. Tabela e mëposhtme përcakton Kategoritë e njësive që do të financohen nga Kredia, shpërndarjen e shumave të Kredisë për çdo Kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për çdo njësi që do të financohet nga secila Kategori.

Kategoria	Shuma e Kredisë (shprehur në ekuivalent të SDR-së)	% e shpenzimeve për t'u financuar
(1) Punime	2,910,000	65%
(2) Mallra	1,920,000	100% e shpenzimeve të huaja, 100% e shpenzimeve lokale (kostoja ex-factory) dhe 83% e shpenzimeve lokale për njësi të tjera të prokuruara në vend
(3) Shërbimet e konsulentëve dhe trajnim	610,000	100%

(4) Kostot shtesë operacionale	150,000	90%
(5) Ripagimi i Avancës për Përgatitjen e Projektit	75,000	Shuma që është për t'u paguar sipas Seksionit 2.02 (2) të kësaj Marrëveshjeje
(6) Të pacaktuara	535,000	
Gjithsej	6,200,000	

2. Për qëllimet e kësaj Shtojce:

(a) termi "shpenzime të huaja" ka kuptimin e shpenzimeve në monedhën e çdo vendi përveç asaj të Huamarrësit për mallra apo shërbime të furnizuara nga territori i çdo vendi me përjashtim të atij të Huamarrësit;

(b) termi "shpenzime lokale" ka kuptimin e shpenzimeve në monedhën e Huamarrësit apo për mallra ose shërbime të furnizuara nga territori i Huamarrësit; dhe

(c) termi "kosto operacionale shtesë" ka kuptimin e kostove operacionale shtesë të PIT-it për llogari të zbatimit, menaxhimit dhe monitorimit të Projektit, duke përfshirë orenditë e zyrës, pajisjet, materialet dhe koston e krijimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe raportimit.

(d) Termi "trajnim" ka kuptimin e aktiviteteve të trajnimit (ndryshe nga aktivitetet e konsulencës) që do të kryhen nën Projektin, duke përfshirë kostot e workshopit dhe shpenzimeve të udhëtimit dhe për diem të trajnimit të stafit të PIT-it

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 e më sipër, asnjë tërheqje nuk do të bëhet për pagesa për shpenzime që janë bërë përpara datës së kësaj së Marrëveshjeje.

4. Shoqata mund të kërkojë që tërheqjet nga Llogaria e Kredisë të bëhen në bazë të deklaratave të shpenzimeve, për shpenzime në lidhje me: (i) punime në bazë të kontratave që kushtojnë më pak se ekuivalenti i 500,000 dollarë secila; (ii) mallra sipas kontratave që kushtojnë më pak se ekuivalentit të 100,000 dollarë secila; (iii) kontrata për firma konsulente që kushtojnë më pak se ekuivalenti të 100,000 dollarë secila; (iv) kontrata për individë konsulentë që kushtojnë më pak se ekuivalenti i 50,000 dollarë secila; dhe (v) kosto operacionale (vi) trajnim, sipas kushteve dhe termave që Shoqata do të specifikojë për Huamarrësin.

B. LLOGARIA E VEÇANTË

1. Huamarrësi do të hapë dhe mbajë një llogari të veçantë në dollarë sipas kushteve të pranuara nga Organizata, përfshirë mbrojtjen e duhur ndaj kompensimit, sekuestrimit dhe konfiskimit.

2. Pasi Organizata të ketë marrë informacion të kënaqshëm se Llogaria e Veçantë është hapur, tërheqjet nga Llogaria e Kreditimit të shumave që do të depozitohen në Llogarinë e Veçantë do të bëhen si më poshtë:

(a) derisa Organizata të ketë marrë (i) Raportin e parë të Menaxhimit të Projektit të përmendur në Seksionin 4.02 (b) të kësaj Marrëveshjeje dhe (ii) një kërkesë nga Huamarrësi për tërheqjen në bazë të Raporteve të Menaxhimit të Projektit, tërheqjet do të bëhen në përputhje me dispozitat e Shtojcës A të Plan-Grafikut 1; dhe

(b) me marrjen nga Organizata të një Raporti të Menaxhimit të Projektit në bazë të Seksionit 4.02 b) të kësaj Marrëveshjeje, të shoqëruar me një kërkesë nga Huamarrësi për tërheqje në bazë të Raporteve të Menaxhimit të Projektit, të gjitha tërheqjet e mëtejshme do të bëhen në përputhje me dispozitat e Shtojcës B të këtij Plan-grafiku 1.

3. Pagesat nëpërmjet Llogarisë së Veçantë do të bëhen ekskluzivisht për shpenzime të pranueshme. Për çdo pagesë të bërë nga Huamarrësi nëpërmjet Llogarisë së Veçantë, Huamarrësi duhet që, në kohën që do ta kërkojë Organizata në mënyrë të arsyeshme, t'i paraqesë Organizatës të gjithë dokumentacionin dhe evidenca të tjera që tregojnë se kjo pagesë është bërë ekskluzivisht për shpenzime të pranueshme.

4. Megjithë dispozitat e Pjesës B.2 të këtij Plan-grafiku, Organizatës nuk do t'i kërkohet të bëjë depozita të tjera në Llogarinë e Veçantë:

(a) në rast se Organizata vendos në çdo kohë se Raporti i Manaxhimit të Projektit nuk jep informacionin e duhur të kërkuar në zbatim të Seksionit 4.02 të kësaj Marrëveshjeje;

(b) në rast se Organizata vendos, në çdo kohë, se të gjitha tërheqjet e mëtejshme duhet të bëhen nga Huamarrësi drejtpërdrejt nga Llogaria e Kreditit; ose

(c) në rast se Huamarrësi nuk do t'i ketë dhënë Organizatës brenda periudhës së specifikuar në Seksionin 4.01 (b) (ii) të kësaj Marrëveshjeje ndonjë pjesë të raporteve të kontrollit financiar të kërkuara për t'iu dhënë Organizatës në zbatim të Seksionit të përmendur në lidhje me kontrollin financiar të (A) rakordimeve dhe llogarive për Llogarinë e Veçantë ose (B) rakordimeve dhe llogarive që pasqyrojnë shpenzimet në lidhje me të cilat u bënë tërheqjet në bazë të Raporteve të Menaxhimit të Projektit.

5. Organizatës nuk do t'i kërkohet të bëjë depozitime të tjera në Llogarinë e Veçantë sipas dispozitave të Pjesës B.2 të këtij Plan-grafiku në rast se, në çdo kohë, Organizata do të ketë njoftuar Huamarrësin për qëllimin e saj, për pezullimin plotësisht ose pjesërisht të së drejtës të Huamarrësit për të bërë tërheqje nga Llogaria e Kreditit, në zbatim të Seksionit 6.02 të Kushteve të Përgjithshme. Pas këtij njoftimi, Organizata do të vendosë, nën arsyetimin e vetëm të saj, nëse mund të bëhen depozitime të tjera në Llogarinë e Veçantë dhe çfarë procedurash duhen ndjekur për t'i bërë këto depozitime dhe për këtë vendim njofton Huamarrësin.

6. (a) Në rast se Organizata vendos në çdo kohë se një pagesë nga Llogaria e Veçantë është bërë për një shpenzim që nuk është shpenzim i pranueshëm, ose nuk ishte i justifikuar në bazë të evidencave të dhëna nga Organizata, Huamarrësi duhet që, menjëherë sapo merr njoftimin e Organizatës, të paraqesë dokumentet shtesë që mund të kërkohen nga Organizata, ose të depozitojë në Llogarinë e Veçantë (ose, në rast se kërkohet nga Organizata, të rifinancojë Organizatën me) një shumë të barabartë me shumën e kësaj pagese. Në rast se Organizata nuk bie dakord ndryshe, në Llogarinë e Veçantë nuk bëhet asnjë depozitim tjetër nga Organizata, deri sa Huamarrësi t'i ketë paraqitur këto dokumenta ose ta ketë bërë këtë depozitim ose rifinancim, sipas rastit.

(b) Në rast se Organizata vendos në çdo kohë të mos kërkohet një shumë e zbuluar në Llogarinë e Veçantë për të mbuluar pagesat për shpenzime të pranueshme gjatë periudhës gjashtë-mujore pas këtij vendimi, Huamarrësi duhet që, menjëherë pas marrjes së këtij njoftimi nga Organizata, të rifinancojë Organizatën me këtë shumë të zbuluar.

(c) Duke njoftuar Organizatën, Humarrësi mund të rifinancojë Organizatën me të gjitha fondet ose një pjesë të fondeve të depozituara në Llogarinë e Veçantë.

(d) Rifinancimet për Organizatën, të bëra në zbatim të nën-paragrafit (a), (b) ose të këtij paragrafi 6, do t'i kreditohen Llogarisë së Kreditimit për tërheqje të mëpasme ose për anullim në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Kredisë së Zhvillimit.

ANEKSI A
PLAN-GRAFIKUT

Veprimet në Llogarinë e Veçantë kur tërheqjet nuk bëhen në bazë
të Raporteve të Menaxhimit të Projektit

1. Për qëllimet e kësaj Shtojce:

(a) termi "Shumë e Autorizuar" do të thotë një shumë e barazvlerëshme me $ 800,000 që duhet të tërhiqet nga Llogaria e Kreditimit dhe të depozitohet në Llogarinë e Veçantë në zbatim të paragrafit 2 të këtij Aneksi; sidoqoftë, me kusht që, në rast se Organizata nuk bie dakord ndryshe, Shuma e Autorizuar të kufizohet në shumën ekuivalente prej $ 400,000 deri sa shuma agregate e tërheqjeve nga Llogaria e Kreditimit, plus shuma e përgjithshme e të gjitha shpenzimeve të veçanta të mbetura në të cilat ka hyrë Organizata në zbatim të Seksionit 5.02 të Kushteve të Përgjithshme të jetë e barabartë me ekuivalentin prej SDR 1,500,000 ose ta kalojë atë.

2. Tërheqjet nga Shuma e Autorizuar e Llogarisë së Veçantë dhe tërheqjet e mëpasme për të plotësuar Llogarinë e Veçantë do të bëhen si më poshtë:

(a) Për tërheqjet e Shumës së Autorizuar të Llogarisë së Veçantë, Huamarrësi do t'i bëjë Organizatës një kërkesë ose disa kërkesa për depozitim në Llogarinë e Veçantë të një shume ose shumave të cilat në total nuk e kalojnë Shumën e Autorizuar. Në bazë të çdo kërkese të tillë, Organizata do të tërheqë, në emër të Huamarrësit, nga Llogaria e Kreditimit dhe do të depozitojë në Llogarinë e Veçantë atë shumë që do të ketë kërkuar Huamarrësi.

(b) Për plotësimin e Llogarisë së Veçantë, Huamarrësi do t'i bëjë Organizatës kërkesa për

depozitim në Llogarinë e Veçantë në ato intervale që mund të specifikohen nga Organizata. Para ose në kohën e secilës prej këtyre kërkesave, Huamarrësi i paraqet Organizatës dokumentacionin dhe evidencat e kërkuara në zbatim të Pjesës B.3 të Plan - grafikut 1 të kësaj Marrëveshjeje për pagesën ose pagesat në lidhje me të cilat kërkohet plotësim. Në bazë të secilës prej këtyre kërkesave, Organizata do të tërheqë nga Credit Account, në emër të Huamarrësit, dhe depozitojë në Llogarinë e Veçantë atë shumë që mund të ketë kërkuar Huamarrësi dhe që do të jetë treguar në dokumentacionin dhe evidencat e mësipërme se janë paguar nga Llogaria e Veçantë për shpenzimet e pranueshme. Secila prej këtyre derdhjeve në Llogarinë e Veçantë do të tërhiqet nga Organizata, nga Llogaria e Kredisë sipas një a më shumë kategori të Pranueshme të Llogarisë së Veçantë.

3. Organizatës nuk do t'i kërkohet të bëjë derdhje të tjera në Llogarinë e Veçantë kur shuma e përgjithshme e patërhequr e Kreditit të caktuar për Kategorinë e Pranueshme të Llogarisë së Veçantë minus shumën e përgjithshme të angazhimeve të veçanta të zbuluara të lidhura nga Organizata në zbatim të Seksionit 5.02 të Kushteve të Përgjithshme, do të jetë e barabartë me dyfishin e Shumës së Autorizuar të Llogarisë së Veçantë. Që këtej, tërheqja nga Llogaria e Kreditimit e shumës së mbetur të patërhequr të Credit do të ndjekë ato procedura që do të specifikojë Organizata e për të cilat do të njoftojë Huamarrësin. Këto tërheqje të mëtejshme do të bëhen vetëm pasi dhe në masën që Organizata të jetë e kënaqur se të gjitha ato shuma që kanë mbetur në depozitë në Llogarinë e Veçantë, që nga data e këtij njoftimi do të përdoren për bërjen e pagesave për Shpenzime të Pranueshme.

ANEKSI B
PLAN-GRAFIKUT 1

Veprimet me Llogarinë e Veçantë kur tërheqjet bëhen në bazë të
Raporteve të Menaxhimit të Projektit

1. Përveç specifikimit ndryshe nga Organizata dhe njoftimit të Huamarrësit për këtë, të gjitha tërheqjet nga Llogaria e Kreditimit do të depozitohen nga Organizata në Llogarinë e Veçantë në përputhje me dispozitat e Plan-grafikut 1 të kësaj Marrëveshjeje. Çdo derdhje e tillë në Llogarinë e Veçantë do të tërhiqet nga Organizata, nga Llogaria e Kreditimit, sipas një a më shumë Kategorive të Pranueshme të Llogarisë së Veçantë.

2. Çdo kërkesë për tërheqje nga Llogaria e Kreditimit, për depozitim në Llogarinë e Veçantë do të shoqërohet me një Raport të Menaxhimit të Projektit.

3. Me marrjen e kësaj kërkese për tërheqje të një shume të Kredisë, Organizata do të tërheqë, në emër të Huamarrësit, nga Llogaria e Kreditimit, dhe do të depozitojë në Llogarinë e Veçantë një shumë të barabartë me më pak se: (a) shumën e kërkuar; dhe (b) shumën që ka përcaktuar Organizata, bazuar në Raportin e Menaxhimit të Projektit shoqëron kërkesën e mësipërme, kërkohet të depozitohet me qëllim që të financohen Shpenzimet Eligible gjatë periudhës gjashtë-mujore pas datës së këtij raporti; megjithatë, me kusht që shuma e depozituar, kur t'i shtohet shumës së treguar nga Raporti i mësipërm i Menaxhimit të Projektit që mbetet në Llogarinë e Veçantë, të mos kalojë ekuivalentin e $ 800,000.

PROJEKT-GRAFIKU 2

Përshkrimi i Projektit

Objektivat e Projektit janë: (a) ulja e shpenzimeve jotarifore të tregtisë dhe të transportit në kufijtë e Huamarrësit; dhe (b) parandalimi i kontrabandës dhe korrupsionit në pikat kufitare të Huamarrësit.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme, të cilat mund të ndryshohen me anë të marrëveshjes midis Huamarrësit dhe Organizatës për çdo rast, për arritjen e këtyre objektivave.

Pjesa A: Reforma e Procedurave të Shërbimeve Doganore

Zbatimi, përmes dhënies së asistencës teknike, trajnimit, pajisjeve dhe masave për reformimin e shërbimeve dhe administratës doganore, duke përfshirë ndërgjegjësimin ndërmjet agjencive.

Pjesa B: Zhvillimi për Lehtësimin e Tregtisë

Zbatimi, përmes dhënies së asistencës teknike, trajnimit, pajisjeve dhe masave për lehtësimin e tregtisë, përfshirë: (a) krijimin e një website rajonal në mbështetje të Programit Rajonal; dhe (b)

zbatimin e masave për përmirësimin e punës së personelit të transportit, operatorëve të transportit dhe agjencive të tjera të përfshira në lehtësimin e tregtisë.

Pjesa C: ICIS

Zbatimi, përmes dhënies së asistencës teknike, trajnimit, pajisjeve dhe masave në mbështetje të ICIS-së, përfshirë: (a) përmirësimin dhe azhornimin e harduerit; (b) dhënien e asistencës teknike dhe të pajisjeve për komunikim; dhe (c) trajnimin e personelit të ICIS-së përmes programit rajonal për këmbimin e informacionit me agjencitë e tjera dhe administratorët e doganave.

Pjesa D: Lehtësitë për Rrugët dhe Pikat Kufitare

(a) Rehabilitimi dhe komplentimi i punimeve të rrugëve dhe urave dhe dhënia e ndihmës teknike në Lezhë, Fushë Krujë-Mamurras dhe Librazhd-Qafë Thanë; (b) përmirësimi dhe modernizimi, përmes ndërtimit të mjediseve dhe sigurimit të pajisjeve dhe asistencës teknike, sipas nevojave, të pikave kufitare të Qafë Thanës dhe Morinës; dhe (c) zgjerimi i kapacitetit përpunues dhe kontrollues në pikat doganore.

Pjesa E: Mbështetja për Projektin dhe Programin Rajonal

Sigurimi i mbështetjes për PIT-in në zbatimin e Projektit, përfshirë sigurimin e humbjeve të bartura të shfrytëzimit, trajnimin dhe shërbimet me konsulentë dhe auditim (kontroll).

***

Projekti parashikohet të përfundojë më 31 dhjetor 2003.

PLAN-GRAFIKU 3

Prokurimi dhe shërbimet e konsulentëve

Seksioni I. Prokurimi i Mallrave dhe Punimeve

Pjesa A: Të përgjithshme

1. Mallrat dhe punimet do të prokurohen në përputhje me (a) dispozitat e Seksionit të materialit "Udhëzime për prokurimin sipas Huave të BERZH-it dhe Kredive të IDA-s" botuar nga Banka në janar 1995 dhe rishikuar në janar dhe gusht 1996, shtator 1997 dhe janar 1999 (Udhëzimet) dhe dispozitat e Pjesëve vijuese të këtij Seksioni I.

2. Në paragrafet 1.6 dhe 1.8 të udhëzimeve, emërtimet "vendet anëtare të Bankës" dhe "vend anëtar" do të merren, përkatësisht, njësoj si emërtimet "Vende Pjesëmarrëse" dhe "Vend Pjesëmarrës".

Pjesa B: Tenderi Ndërkombëtar Konkurrues

1. Përveç asaj që parashikohet ndryshe në Pjesën C të këtij Seksioni, mallrat dhe punimet do të prokurohen në bazë të kontratave të lidhura në përputhje me dispozitat e Seksionit II të Udhëzimeve dhe paragrafit 5 të Aneksit I të tyre.

2. Dispozitat e mëposhtme do të zbatohen për mallrat dhe punimet që duhet të prokurohen në bazë të kontratave të lidhura në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të kësaj Pjese B.

(a) Grupimi i Kontratave

Derisa është e aplikueshme, kontratat për punimet duhet të grupohen në paketa tenderimi me kosto ekuivalente me $ 500,000 apo më shumë secila, dhe kontratat për mallrat duhet të grupohen në paketa tenderimi me kosto ekuivalente me $ 100,000 apo më shumë secila.

(b) Preferenca për mallrat e prodhuara në vend dhe kontraktore vendas

Dispozitat e paragrafeve 2.54 dhe 2.55 të Udhëzimeve dhe Aneksit 2 të tyre do të zbatohen për mallrat e prodhuar në territorin e Huamarrësit dhe për punimet që do të kryhen nga kontraktorë vendas.

Pjesa C: Procedura të Tjera të Prokurimit

BLERJET NË VEND

Mallrat që llogaritet se kushtjnë më pak se ekuivalenti $ 100,000 për kontratë, deri në një shumë të përgjithshme që të mos e kalojë ekuvalentin $ 300,000 mund të blihen sipas kontratave të lidhura në bazë të procedurave vendore të blerjes në përputhje me dispozitat e paragrafëve 3.5 dhe 3.6 të Udhëzimeve.

Pjesa D: Kontrolli nga Organizata e Vendimeve të Prokurimit

1. Planifikimi i Prokurimit

Para nxjerrjes së ndonjë ftese për organizim tenderi kontratash, plani i propozuar i prokurimit për Projektin do t'i paraqitet Organizatës për rishikim dhe miratim, sipas dispozitave të paragrafit 1 të Aneksit 1 të Udhëzimeve. Prokurimi i të gjitha mallrave dhe punimeve do të ndërmerret në përputhje me planin e prokurimit që do të miratohet nga Organizata dhe dispozitat e paragrafit të përmendur.

2. Rishikimi Paraprak

Në lidhje me çdo kontratë, që do të prokurohet në përputhje me procedurën e përmendur në Pjesën B të këtij Plan-grafiku, do të zbatohen procedurat e parashikuara në paragrafet 2 dhe 3 të Shtojcës 1 të Udhëzimeve.

3. Rishikimi i Mëpasëm

Në lidhja me çdo kontratë që nuk rregullohet nga paragrafet 2 të kësaj Pjese, do të zbatohen procedurat e parashikuara në paragrafin 4 të Shtojcës së Udhëzimeve.

Seksioni II. Pajtimi i Konsulentëve

Pjesa A: Të Përgjithshme

1. Shërbimet e konsulentëve do të prokurohen në përputhje me (a) dispozitat e Hyrjes dhe të Seksionit IV të materialit "Udhëzimet: Përzgjedhja dhe Pajtimi i Konsulentëve nga Humarrësit e Bankës Botërore" botuar nga Organizata në janar 1997 dhe rishikuar në shtator 1997 dhe janar 1999, në varësi të ndryshimeve të bëra të përcaktuara në paragrafin 2 të kësaj Pjese A (Udhëzimet për Konsulentët), dhe (b) dispozitat e Pjesëve vijuese të këtij Seksioni II.

2. Në paragrafet 1.10 të Udhëzimeve për Konsulentët, emërtimet "vende anëtare të Bankës" dhe "vend anëtar" do të merren, përkatësisht, njësoj si emërtimet "Vende Pjesëmarrëse" dhe "Vend Pjesëmarrës".

Pjesa B: Përzgjidhja sipas Cilësisë dhe Kostos

Përveç asaj që parashikohet ndryshe në Pjesën C të këtij Seksioni, shërbimet e konsulentëve do të prokurohen në bazë të kontratave të lidhura në përputhje me dispozitat e Seksionit II të Udhëzimeve për Konsulentët, paragrafi 3 i Shtojcës 1 të tyre, Shtojcës 2 të tyre dhe dispozitat e paragrafeve 3.13 deri në 3.18 të tyre të zbatueshme për përzgjedhjen e konsulentëve, sipas cilësisë dhe kostos.

Pjesa C: Procedura të tjera për Përzgjedhjen e Konsulentëve

1. Përzgjedhja sipas kostos më të ulët

Shërbimet për kryerjen e auditimeve sipas Projektit mund të prokurohen në bazë të kontratave të lidhura në përputhje me dispozitat e paragrafeve 3.1 dhe 3.6 të Udhëzimeve për Konsulentët.

2. Përzgjedhja e Bazuar në Kualifikimet e Konsulentit.

Shërbimet për trajnimin e personelit të ICIS-së që llogariten të kushtojnë më pak se ekuivalenti $ 100,000 për kontratë, mund të prokurohen në bazë të kontratave të lidhura në përputhje me dispozitat e paragrafëve 3.1 dhe 3.7 të Udhëzimeve për Konsulentët.

3. Konsulentët Individualë

Shërbimet për detyra që i plotësojnë kërkesat e parashikuara në paragafin 5.1 të udhëzimeve për Konsulentët do të prokurohen në bazë të kontratave të lidhura me konsulentë të veçantë, në përputhje me dispozitat e paragrafeve 5.1 deri në 5.3 të Udhëzimeve për Konsulentët.

Pjesa D: Rishikimi nga Organizata e Përzgjedhjes së Konsulentëve

1. Planifikimi i Përzgjedhjes

Para nxjerrjes për konsulentët të ndonjë kërkese për propozime, plani i propozuar për përzgjedhjen e konsulentëve në bazë të Projektit do t'i paraqitet Organizatës për kontrollin dhe miratimin e saj, sipas dispozitave të paragrafit 1 të Shtojcës 1 të Udhëzimeve për Konsulentët. Përzgjedhja e shërbimeve të konsulentëve do të ndërmerret në përputhje me planin e përzgjedhjes që do të miratohet nga Organizata dhe me dispozitat e paragrafit 1 të përmendur.

2. Rishikimi Paraprak

(a) Në lidhje me çdo kontratë për pajtimin e firmave të konsulentëve, që llogaritet të kushtojë në ekuivalentin $ 100,000 ose më shumë, do të zbatohen procedurat e parashikuara në paragrafet 1,2 (dhe jo nënparagrafi i tretë i paragrafit 2(a) dhe 5 të Shtojcës 1 të Udhëzimeve për Konsulentët.

(b) Në lidhje me çdo kontratë për pajtimin e konsulentëve të veçantë që llogaritet të kushtojë në ekuivalentin $ 50,000, ose më shumë, kualifikimet, përvoja, termat e referencës dhe kushtet e pajtimit të konsulentëve do t'i paraqiten Organizatës për rishikim dhe miratim paraprak. Kontrata do të

lidhet vetëm pasi të jetë marrë miratimi i mësipërm.

3. Rishikimi më pas

Në lidhje me çdo kontratë që nuk rregullohet nga paragrafi 2 i kësaj Pjese, do të zbatohen procedurat e parashikuara në paragrafin 4 të Shtojcës 1 të Udhëzimeve.

PLAN-GRAFIKU 4

Programi i Zbatimit

A. Përgjegjësitë e Zbatimit

1. PIT-i, që vepron nën varësinë e Menaxherit të Projektit, kryen të gjitha detyrat teknike për Zbatimin e Projektit, duke përfshirë: (a) përgatitjen e planit vjetor për Zbatimin e Projektit; (b) përgatitjen, me ndihmën e konsulentëve, të dokumentacionit të tenderit dhe kontratave sipas Projektit; (c) mbajtjen e pasqyrave dhe llogarive financiare dhe organizimin e kontrollit të tyre; (d) përgatitjen e raporteve tremujore për ecurinë e Projektit, përmendur në Pjesën B të këtij Programi; dhe (e) mbikëqyrjen e ecurisë së Zbatimit të Projektit.

2. Huamarrësi duhet të sigurojë që PIT-i të ruhet deri në përfundimin e Projektit sipas termave të referencës dhe stafin dhe masa të tjera të jenë të pranueshme nga Organizata.

3. Huamarrësi duhet të sigurojë: (a) që çdo plan vjetor për Zbatimin e Projektit të përmendur në paragrafin (1) më lart do të përgatitet pas një rishikimi midis Huamarrësit dhe Organizatës të ecurisë në plotësimin e objektivave të treguar në PIP, përfshirë objektivat e përcaktuar në Aneksin e këtij Programi; dhe (b) që përfshirja e investimeve dhe veprimtarive të tjera për Projektin në planin e mësipërm, si dhe organizimi i prokurimit të tyre, do të bëhen sipas një marrëveshjeje midis Huamarrësit dhe Organizatës, duke marrë parasysh kërkesat e parashikuara në Planin e Menaxhimit të Mjedisit.

4. Huamarrësi duhet: (a) të ruajë pjesëmarrjen në RSC; dhe (b) të informojë Organizatën për veprimet e kryera në nivelin e RSC-së që mund të prekin zbatimin e Programit Rajonal ose për masat e përfshira në PIP.

5. Huamarrësi duhet të sigurojë ngritjen nga Koordinatori i Projektit deri më Mars 2001 të mekanizmave në të gjitha agjencitë kufitare për t'i dhënë Koordinatorit të Website informacionin aktual që duhet të vihet në dispozicion të përdoruesve të doganës në orët e pritjes dhe orët e hapjes në pikat kufitare dhe rregulloret dhe procedurat doganore të agjencive kufitare.

B. Raportimi

Huamarrësi duhet të sigurojë: (a) përgatitjen nga PIT për paraqitjen në Organizatë të raporteve tremujore mbi ecurinë e zbatimit të Projektit; dhe (b) bashkimin e raporteve të përmendur të ecurisë në raporte gjysëm-vjetore për ecurinë që duhet t'i paraqiten Organizatës dhe RSC-së.

C. Monitorimi

Huamarrësi duhet:

(a) të vendosë politika dhe procedura të përshtatshme për të mundësuar monitorimin dhe vlerësimin nga ana e tij në mënyrë të vazhdueshme, në përputhje me treguesit e përfshirë në PIP, përfshirë ata të përcaktuar në Aneksin e këtij programi, realizimin e objektivave të Projektit.

(b) të përgatisë, në bazë të termave të referencës të pranueshme për Organizatën, dhe t'i paraqesë Organizatës deri në 15 tetor të çdo viti, një raport që integron rezultatet e veprimtarive të monitorimit dhe të vlerësimit të kryera në zbatim të paragrafit (a) të këtij Seksioni, mbi ecurinë e arritur në realizimin e Projektit gjatë periudhës para datës së raportit të përmendur dhe që përcakton masat e rekomanduara për të siguruar realizimin me efektivitet të Projektit dhe realizimin e objektivave të tij gjatë periudhës pas kësaj date; dhe

(c) të rishikojë me Organizatën deri në 15 nëntor të çdo viti ose asaj date të mëvonshme që do të kërkohet nga Organizata, raportin e përmendur në paragrafin (b) të këtij Seksioni dhe, pas kësaj, të marrë të gjitha masat që kërkohen për të siguruar përfundimin me sukses të Projektit dhe realizimin e objektivave të tij, bazuar në përfundimet dhe rekomandimet e raportit të përmendur dhe mendimet e Organizatës për këtë çështje.

ANEKSI I
PLAN-GRFAFIKUT 4

Përveç asaj për të cilën Organizata mund të bjerë dakord ndryshe, Huamarrësi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për arritjen e këtyre objektivave:

(a) Numri i përgjithshëm i deklarimeve në dogana që çojnë në një inspektim fizik nga GDC në terminalin e brendshëm pilot nuk duhet të kalojë në bazë mujore; (i) 60 për qind deri në 30 shtator 2001; (ii) 35 për qind deri në shtator 2002; dhe (iii) 25 për qind deri në 30 shtator 2003.

(b) Numri mujor i kamionëve që realizojnë përpunimin në doganë të importeve në më pak se në terminalin e brendshëm pilot duhet të kalojë: (i) 10 për qind deri në 30 shtator 2001; (ii) 30 për qind deri në 30 shtator 2002; dhe (iii) 40 për qind deri në 30 shtator 2003.

(c) Numri i kamionëve të hapur në bazë mujore në pikën kufitare pilot të Qafë Thanës nuk duhet të kalojë: (i) 60 për qind deri në 30 shtator 2001; (ii) 40 për qind deri në 30 shtator 2002; dhe (iii) 20 për qind deri në 30 shtator 2003.

(d) Numri i kontenierëve të hapur në bazë mujore në pikën kufitare pilot të Durrësit nuk duhet të kalojë: (i) 80 për qind deri në 30 shtator 2001; (ii) 50 për qind deri në 30 shtator 2002. Dhe (iii) 20 për qind deri në 30 shtator 2003.

ANEKSI I
PLAN-GRAFIKUT 4

Përveç asaj për të cilën Organizata mund të bjerë dakord ndryshe, Huamarrësi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për arritjen e këtyre objektivave:

(a) Numri i përgjithshëm i deklarimeve në dogana që çojnë në një inspektim fizik nga GDC në terminalin e brendshëm pilot nuk duhet të kalojë në bazë mujore: (i) 60 për qind deri në 30 shtator 2001; (ii) 35 për qind deri në shtator 2002; dhe (iii) 25 për qind deri në 30 shtator 2003.

(b) Numri mujor i kamionëve që realizojnë përpunimin në doganë të importeve në më pak se në terminalin e brendshëm pilot duhet të kalojë: (i) 10 për qind deri në 30 shtator 2001; (ii) 30 përqind deri në 30 shtator 2002; dhe (iii) 40 përqind deri në 30 shtator 2003.

(c) Numri i kamionëve të hapur në bazë mujore në pikën kufitare pilot në Qafë Thanës nuk duhet të kalojë; (i) 60 përqind deri në 30 shtator 2001; (ii) 40 për qind deri në 30 shtator 2002; dhe (iii) 20 përqind deri në 30 shtator 2003.

(d) Numri i kontenierëve të hapur në bazë mujore në pikën kufitare pilot të Durrësit nuk duhet të kalojë: (i) 80 për qind deri në 30 shtator 2001; (ii) 50 për qind deri në 30 shtator 2002; dhe (iii) 20 për qind deri në 30 shtator 2003.

L I G J
Nr. 8748, datë 1.3.2001

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PANHELLENIC EXPORTERS ASSOCIATION PËR KONSOLIDIMIN E BORXHIT TË JASHTËM TË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Panhellenic Exportes Association për konsolidimin e borxhit të jashtëm të Shqipërisë".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2920, datë 9.3.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE PANHELLENIC EXPORTERS ASSOCIATION PËR KONSOLIDIMIN E BORXHIT TË JASHTËM TË SHQIPËRISË

MARRËVESHJE, datë 16.1.2001, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë (Qeveria), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Panhellenic Exporters Association (PEA).

Neni 1

Subjekt i kësaj Marrëveshjeje është konsolidimi i borxheve, për shumën e papaguar të faturave dhe interesat mbi këto shuma, që rrjedhin nga transaksionet tregtare të përfunduara para 31.12.1991, të mbetura të papaguara deri më 20.10.2000.

Shuma e borxheve është si vijon:

Nr	Emri i kompanisë	Shuma e Faturës së papaguar	Interesi
1	M.J.MAILIS S.A	30.125,00 DEM	12.954 DEM
2	HELLENIC STEEL CO.	251.854,00 USD	108.095 USD
3	LENCO TRADING LTD	23.222,00 USD	9.376 USD
4	HALCOR S.A.	11.353,00 USD	5.010 USD
5	FITCO S.A	14/721,00 USD	6.496 USD
6	HADJILUCAS S.A	12.612,60 USD	5.565 USD
7	N.LEVENTERIS S.S	184.663,88 USD	81.482 USD
8	D. ZOUKAS & CO.	162.705,00 USD	62.031 USD
9	STEFANOS KOLOBOS-DIM KARAPETSOS	10.200,00 USD	4.271 USD
10	CARMYCO, N&C.CARAMANIS	31.302,40 USD	13.577 USD
11	ELSA. S.A	370.000,00 DEM	156.788 DEM
12	GENERAL-IMPORT-EXPORT	32.533.000,00 GRD	14.355.186 GRD
	LTD CO.	31.372,00 USD	13.843 USD
13	AUSTRO-HELLENIQUE SOCIETE ANONYM TABAC	56.591,82 USD	27.517 USD

Neni 2

Panhellenic Exporters Association heq dorë nga kërkesa e shumës prej 337.263 USD, 169.742 DEM dhe 14.355.186 GRD, që rrjedhin nga interesat.

Neni 3

"Qeveria" angazhohet t'i paguajë "PEA-s" sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se 31.03.2001, shumën prej 790.597,70 USD, 400.125,00 DEM dhe 32.533.000 GRD.

Neni 4

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit përfundimtar me të cilin të dyja palët do të njoftojnë zyrtarisht përfundimin e procedurave të brendshme të parashikuara nga rregullat respektive.

Nëse çdonjëra nga palët dështon në plotësimin e detyrimeve të saj, kjo Marrëveshje do të konsiderohet e pavlefshme.

Bërë më 16.01.2001, në 2 kopje origjinale, në gjuhën anglisht.

Për Qeverinë e Republikës së ShqipërisëPanhellenic Exports Association

Nga Anastas ANGJELINga Dionisios NIOTIS

MINISTËR I FINANCAVEDREJTOR

D E K R E T
Nr.2907, datë 21.2.2001

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të nenit 20 dhe nenit 9 pika 7, të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministres së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

D E K R E T O J:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij

1. Besnik Imer Hasi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

D E K R E T
Nr.2914, datë 6.3.2001

PËR LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15,19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U hiqet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Olsi Ilirjan Llakaj
2. Mirjana Jani Kaufmann (Dedja)
3. Albert Hasan Lamaj
4. Annakatrin Albert Lamaj
5. Eric Albert Lamaj
6. Anila Ali Lamaj (Myrtolli)
7. Fatmir Petrit Bektashi
8. Shefik Rustem Nako
9. Gjergji Arqile Shana
10. Ilir Haxhi Tole
11. Shpëtim Mustafa Rruga
12. Auron Anastas Dodi
13. Artur Lulzim Shehu
14. Aleksandër Stefan Nikolla
15. Artan Faik Durishti
16. Laureta Thoma Qirko (Plaku)
17. Kostandin Alfred Qirko
18. Marina Alfred Qirko
19. Tom Alfred Qirko
20. Marjana Aleko Llakmani (Xhillari)
21. Claudio Pavli Llakmani
22. Erandi Kolec Kola
23. Bujar Ibrahim Abati
24. Paul Bujar Abati
25. Nancy Bujar Abati
26. Edmond Bajram Selimaj
27. Elsion Edmond Selimaj
28. Endrju Edmond Selimaj
29. Andi Edmond Selimaj
30. Luiza Haxhi Selimaj (Shehu)
31. Avni Sehit Azizi
32. William Avni Azizi
33. Lorin Avni Azizi
34. Eqerem Sehit Azizi
35. Klaudia Eqerem Azizi
36. Kevin Eqerem Azizi
37. Artjan Nuri Bylyku
38. Larissa Crejsy Artjan Bylyku
39. Abedin Brahim Gaxha
40. Samanda Abedin Gaxha
41. Jani Dhimitër Dede
42. Jona Jani Dede
43. Flutura Masar Dede (Dibra)
44. Valmir Vasil Ziu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

V E N D I M
Nr.27, datë 20.1.2001

PËR VENDOSJEN E KUTIVE POSTARE NË NDËRTESA BANIMI DHE NË INSTITUCIONE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 6 të ligjit nr.8530, datë 23.9.1999, "Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Vendosjen e kutive postare në të gjithë projektet për ndërtesat e reja, objekte banimi, institucione social-kulturore dhe ente prodhuese.

Kutitë postare dhe lloji i tyre të vendosen nga vetë investitorët, në varësi të funksionit të ndërtesës.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Punëve Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.31, datë 20.1.2001

PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Komisioni mjekësor i caktimit të aftësive për punë (KMCAP), në rreth, shqyrton të gjitha kërkesat e paraqitura nga personat e interesuar, që përfitojnë nga ligji nr.8626, datë 22.6.2000, pavarësisht nga mosha, nga fakti nëse janë ose jo në marrëdhënie pune, nga koha a vendndodhja e aksidentit apo nga çasti i sigurimit.

Komisioni vendos edhe shkallën e invaliditetit, sipas ndarjes që vijon:

I. Grupi i parë, ku përfshihen:

a) të sëmurët tetraplegjikë, që kanë humbur mbi 55 për qind të aftësisë për punë, që nuk kanë mundësi fizike për të vetëshërbyer e që kanë nevojë për kujdestar.

b) të sëmurët paraplegjikë, që kanë humbur mbi 55 për qind të aftësisë për punë, që nuk kanë mundësi fizike për të vetëshërbyer e që kanë nevojë për kujdestar.

II. Grupi i dytë, ku përfshihen të sëmurët paraplegjikë pjesërisht të aftë për punë të përzgjedhur, që janë në gjendje për të vetëshërbyer.

2. KMCAP-ja i lëshon të interesuarit raportin mjekësor, duke përcaktuar shkallën e paaftësisë dhe nevojën për kujdestar. Invalidi, paraplegjik ose tetraplegjik, duhet të deklarojë para administratorit shtetëror emrin e kujdestarit i cili shënohet në një regjistër të veçantë. Ndërrimi i kujdestarit mund të bëhet sa herë që invalidi, paraplegjik ose tetraplegjik, e sheh të arsyeshme, por është i detyruar të njoftojë menjëherë KMCAP-në.

3. Invalidët, paraplegjikë ose tetraplegjikë, pajisen me dëshmi zyrtare identifikimi.

4. Masa e pagesës për invalidët, paraplegjikë ose tetraplegjikë është 70 për qind e pagës minimale të punonjësit buxhetor dhe ndryshon sa herë ndryshon kjo pagë. Pagesa përfitohet pavarësisht nga mosha dhe të ardhurat e tjera, që invalidi, paraplegjik ose tetraplegjik, përfiton nga shteti. Të njëjtën pagesë përfiton edhe kujdestari i invalidit, paraplegjik ose tetraplegjik, i caktuar në përputhje me pikën 1 të këtij vendimi.

Vendi dhe mënyra e dhënies së këtyre pagesave do të përcaktohet në udhëzimin që do të dalë në zbatim të këtij vendimi.

5. Efektet financiare për këto pagesa të përballohen brenda fondeve të dhëna për vitin 2001, Administratës së Përgjithshme të Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale, në zërin "Përfitim paaftësie".

6. Personat që do të fitojnë statusin e invalidit, paraplegjik ose tetraplegjik, para datës 30 qershor 2001, do ta përfitojnë këtë pagesë, në zbatim të pikës 4 të këtij vendimi, që nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, "Statusi i invalidit, paraplegjik ose tetraplegjik."

Të gjithë personat e tjerë që do ta fitojnë këtë status pas datës 30 qershor 2001, do ta përfitojnë këtë pagesë një muaj pas daljes në KMCAP.

7. Për çdo shpërdorim, personit përgjegjës i merret dëshmia për një periudhë deri në 3 vjet dhe, sipas rastit, zbatohen edhe dispozitat për kundërvajtjet administrative deri në kallëzim për ndjekje penale.

8. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Financave të nxjerrin udhëzimet përkatëse, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.54, datë 2.2.2001

PËR KALIMIN E OBJEKTEVE KULTURORE TË ISH-NDËRMARRJEVE BUJQËSORE, NË PRONËSI TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr.8340/1, datë 6.5.1998 "Për rregullimin e pasojave që kanë rrjedhur nga zbatimi i dekretit nr.204, datë 5.6.1992 "Për pasuritë e sindikatave", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kalimin e objekteve kulturore të ish-ndërmarrjeve bujqësore, nga pasuri e sindikatave të fituara në zbatim të dekretit nr.204, datë 5.6.1992, të Presidentit të Republikës, "Për pasuritë e sindikatave", në pronësi të organeve të qeverisjes vendore, në territorin e të cilit ndodhet objekti.

2. Kalimi i objekteve të mësipërme, të bëhet me dokumentacion të rregullt dorëzimi, brenda 2 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Krijimin e komisionit të posaçëm, për kalimin e këtyre objekteve, me këtë përbërje:

3 përfaqësues të organit të qeverisjes vendore, përkatëse.

3 përfaqësues të sindikatave përkatëse.

Drejtuesit e organeve të qeverisjes vendore dhe të sindikatave përkatëse, të pajisin me autorizim përfaqësuesit e tyre, të cilat i bashkëlidhen procesverbalit të dorëzimit.

4. Pas marrjes në dorëzim të objekteve, organet e qeverisjes vendore, të bëjnë regjistrimin e tyre sipas ligjit "Për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme".

5. Ngarkohen organet përkatëse të qeverisjes vendore në territorin e të cilit ndodhet objekti, të kërkojnë përfitimin e objektit, në rrugë gjyqësore, në rastet e privatizimit të paligjshëm të objektit.

6. Ngarkohen bashkitë dhe komunat përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

7. Ngarkohen prefektët për kontrollin e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.55, datë 2.2.2001

PËR ORGANIZIMIN E STRUKTURËS SË ZYRAVE TË GJENDJES CIVILE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 16 të nenit 5, të ligjit nr.7608, datë 22.9.1992 "Për prefekturat", ndryshuar me ligjin nr.8209, datë 22.4.1997, të nenit 12 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" dhe të ligjit nr.5840, datë 20.2.1979 "Mbi regjistrimin e akteve të gjendjes civile", me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kryetarët e bashkive, të komunave dhe të njësive bashkiake të Tiranës administrojnë e drejtojnë zyrat e gjendjes civile, dhe janë përgjegjës për funksionimin e tyre, në përputhje me aktet ligjore.

2. Nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashki dhe në komuna kryejnë detyrat e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, përkatëse.

3. Nëpunësit e gjendjes civile emërohen dhe shkarkohen:

a) në bashki, në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil";

b) në komuna, në përputhje me shkronjën "f" të nenit 44 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për orgnizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".

4. Numri i zyrave të gjendjes civile, numri i punonjësve dhe struktura organizative e zyrave të gjendjes civile, që do të funksionojnë në çdo bashki dhe komunë, caktohen nga Ministria e Pushtetit Lokal, brenda treguesve të buxhetit të vitit përkatës.

5. Kontrolli i veprimtarisë së zyrave të gjendjes civile, në bashki dhe komuna, kryhet nga prefekti i qarkut.

6. Prefekti drejton dhe administron zyrat e gjendjes civile në çdo rreth. Nëpunësit e gjendjes civile në rreth emërohen dhe shkarkohen nga prefekti.

7. Fondi i pagave, i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe shpenzimet e tjera për nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile, mbulohen nga buxheti i shtetit dhe dërgohen me titull të veçantë në çdo bashki, komunë e prefekturë.

8. Niveli i pagave të punonjësve të gjendjes civile përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

9. Vendimi nr.161, datë 11.3.1996, i Këshillit të Ministrave, "Për organizimin e strukturave të gjendjes civile", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.56, datë 2.2.2001

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË ÇMIMEVE TË BARNAVE, TË PËRFSHIRA NË LISTËN E BARNAVE TË RIMBURSUARA, ME VENDIMIN NR.610, DATË 17.11.2000, TË

KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të kreut IX, nenit 44 të ligjit nr.7815, datë 20.4.1994, "Për barnat", të neneve 4 dhe 15, të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994, "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë" dhe të vendimit nr.241, datë 18.5.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për riorganizimin dhe funksionimin e komisionit të çmimeve të barnave", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e strukturës së çmimeve të barnave, të përfshira në listën e rimbursimeve, me vendimet nr.610, datë 17.11.2000 dhe nr.54, datë 2.2.1996, të Këshillit të Ministrave, sipas pasqyrës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efekti financiar, prej 154 000 000 (njëqind e pesëdhjetë e katër milionë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2001, i miratuar për Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

PASQYRA NR.1
ÇMIMET E BARNAVE QË RIMBURSOHEN NGA INSTITUTI I SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Kod Bari	Emërtimi dhe fuqia e barit	Forma	Emri tregtar	Firma Farmaceutike	Çmimi Reference	Çmimi Pacienti	Rimbursimi	Kufizime
281	Danazol 200 mg	kaps	Danatrol	Sanofi	170	17	153	Vetëm në Edemat Angio-neurotike të trashëguara. Me konsultë të QSUT-së.Në muaj 15 tableta
282	Finasteride 5 mg	tabl.	Proscar	Msharp & Dohme	266	67	199	Vetëm në Hiperplazi beninje të prostatës mbi 40 ml. Me konsultë të urologut. Në muaj 30 kapsula. Sipas protokollit të ISKSH-së.
283	Dihydrotachisterol 0.1%-15 ml	fl.	Tachystin	Bayer*	1979	198	1781	Vetëm në Hypoparatyroidizëm kronik. Me

								rekomandim të QSUT-së. Sipas protokollit të ISKSH-së.
284	Tamsulosin 400 mcg	kaps.	Omnic	Yamano uchi	125	31	94	Vetëm në Hiperplazi beninje të prostatës nga 25-40 ml. Me konsultë të urologut. Në muaj 30 kapsul. Sipas protokollit të ISKSH-së.
285	Letrozol 2.5 mg	drazhe	Femara	Novartis	701	0	701	Vetëm në Ca mamae. Me konsultë të QSUT-së. Në muaj 30 tableta
286	Ciclosporin 25 mg	kaps.	Sandi Mum Neoral	Novartis	170	0	170	
287	Ciclosporin e 50 mg	kaps.	Sandi Mum Neoral	Novartis	329	0	329	Vetëm pas transplanteve renale. Me konsultë të QSUT-së. Sipas protokollit të ISKSH-së.
288	Ciclosporin e 100 mg	kaps.	Sandi Mum Neoral	Novartis	641	0	641	Vetëm pas transplanteve renale. Me konsultë të QSUT-së. Sipas protokollit të ISKSH-së.
289	Respiridon 4 mg	tabl.	Rispole pt	Janssen Cilag	425	106	319	Vetëm në Psikoanalizat refraktare si alternative e Clozapinës.

V E N D I M
Nr.57, datë 2.2.2001

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË AFATMESME DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT, PËR ZHVILLIMIN E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të vendimit nr.422, datë 5.11.1999, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, "Për miratimin e përbërjes dhe të programit politik të Këshillit të Ministrave", me propozimin e Ministrit të Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e strategjisë afatmesme dhe të planit të veprimit, për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.59, datë 2.2.2001

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.364, DATË 14.7.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE QË SHKURTOHEN NGA ZBATIMI I MARRËVESHJES SË KONCESIONIT PËR UZINËN E FERROKROMIT, ELBASAN DHE MINIERAT E KROMIT, PËRRENJAS DHE POJSKË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6 të ligjit nr.8562, datë 22.12.1999, "Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime, "Albkrom"", dhe të nenit 9 të ligjit nr.8590, datë 23.3.2000, "Për miratimin e marrëveshjes së koncesionit, të formës "BOT", për Uzinën e Ferrokromit, Elbasan, dhe minierat e kromit Përrenjas e Pojskë, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe shoqërisë italiane, Darfo, S.p.A., dhënien e disa stimujve dhe garancive për koncesionarin e kësaj marrëveshjeje", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.364, datë 14.7.2000 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si vijon:

"2. Fondet financiare, prej 129 milionë lekësh, të nevojshme për shpërblimin e 398 punonjësve të Uzinës së Ferrokromit, Elbasan, të minierave të kromit, Përrenjas dhe Pojskë, dhe të administratës së "Albkrom", sh.a., që kanë mbuluar këto njësi e që do të trajtohen sipas këtij vendimi, të përballohen nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

a) Për vitin 2000, shumën 64.5 milionë lekë, me fondet e dhëna nga koncensionari dhe nga fitimi i "Taulantia", sh.a, të vitit 2000, në shumën 36.3 milionë lekë.

b) Për vitin 2001 shumën 64.5 milionë lekë, nga fondet e dhëna nga koncesionari, 200 000 USD, dhe diferenca nga fondet e krijuara, në zbatim të vendimit nr.416, datë 9.7.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për administrimin dhe përdorimin e të ardhurave të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, nga privatizimi i shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë.".

2. Pika 3 ndryshohet si vijon:

"3. Përfitojnë nga ky vendim punonjësit e Uzinës së Ferrokromit, Elbasan, të minierave të

kromit, Përrenjas dhe Pojskë, dhe të administratës së "Albkrom", sh.a., që kanë mbuluar këto njësi, të cilët kanë qenë të punësuar pranë tyre, pa ndërprerje, që nga 1.6.1999 e deri më datën 19.7.2000, data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.63, datë 26.1.2001

PËR PROCEDURAT E KËRKIMIT, TË SHQYRTIMIT DHE TË DHËNIES SË AUTORIZIMEVE, TË LEJEVE DHE KONCESIONEVE PËR PËRDORIMIN E REZERVAVE UJORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të neneve 6,7,12,18 dhe 72 të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996, "Për rezervat ujore", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Deklarimet për përdorim të lirë të rezervave ujore, në mbështetje të pikës 1 të nenit 13 të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996, të bëhen pranë agjencive të ujit të këshillave të baseneve ujëmbledhëse, (shkurt agjencia), në përputhje me formularët e miratuar nga Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU).

2. Kërkesat për leje dhe autorizime të paraqiten në:

a) Agjenci, kur veprimtaria për të cilën kërkohet përdorimi i rezervës ujore parashikohet të kryhet brenda kufirit të basenit;

b) Sekretariatin teknik të KKU-së (tani e tutje sekretariati), kur veprimtaria parashikohet të kryhet jashtë kufirit të një baseni të vetëm, ose

c) Sekretariat, kur veprimtaria është "lundrueshmëri", ose "ndërtim strukturash, ankoruese dhe portuale".

3. Kërkesa për përdorim me koncesion të një rezerve ujore, në funksion të prurjes së kërkuar të rezervës ujore, do të paraqitet pranë agjencisë ose sekretariatit, sipas tabelave nr.1 dhe nr.2 të këtij vendimi (kolonat 10 dhe 11).

4. Dhënia e lejeve, e autorizimeve dhe koncesioneve për përdorimin e rezervave ujore, me përjashtim të rasteve të pikës 5 të këtij vendimi, të bëhet me procedurë tenderimi.

- Në rastet kur vetë Autoriteti i Ujit gjykon se një rezervë ujore mund të jepet për përdorim, shpallet tender, duke kërkuar propozime nga subjekte të interesuara (propozime të kërkuara).

- Në rastet kur pranë Autoriteteve të Ujit paraqitet një kërkesë për përdorim rezerve ujore (propozim i pakërkuar) tenderi shpallet pas "miratimit, në parim" për përdorimin e burimit, sipas pikës 6 të këtij vendimi.

Për tenderim të përdoren dy forma procedure:

a) Tender i hapur

Tender i hapur u drejtohet subjekteve vendase, por pa u mohuar të drejtën e pjesëmarrjes edhe të subjekteve të huaja, të interesuara. Publikimi kryhet në dy gjuhë: shqip dhe anglisht, ndërsa procedurat e tjera vazhdojnë vetëm në shqip.

b) Tenderi ndërkombëtar

Tenderi ndërkombëtar u drejtohet të gjitha subjekteve, vendase dhe të huaja. Publikimi dhe e gjithë procedura kryhet në dy gjuhë: shqip dhe anglisht.

5. Përjashtohen nga procedura e tenderimit rezervat ujore, të cilat deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi, përdoren:

a) për furnizimin me ujë të pijshëm të popullsisë, nga ndërmarrjet (ose sh.a.-të) e ujësjellësve.

b) për ujitje, nga federata apo shoqatat e përdoruesve të ujit.

c) për hidroenergji.

Në këto raste të lidhen marrëveshje koncesionare, ndërmjet autoriteteve të ujit dhe:

- përfaqësuesit të pushtetit vendor, që zotëron asetet e ndërmarrjes së ujësjellësit, për rastet e pikës 5/a.
- Drejtorisë së Ujërave, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit, për rastet e pikës 5/b.
- Koorporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), për rastet e pikës 5/c.

Marrëveshjet koncesionare, për rastet e pikës 5 të lidhen sipas grafikut dhe formularëve tip për secilin nga tre rastet e miratuara nga KKU-ja.

6. Agjencia Sekretariati paraqet për "shqyrtim" dhe "miratim në parim", në mbledhjen e radhës së KBU-së ose KKU-së, mundësinë e dhënies në përdorim të rezervave ujore, të kërkuara sipas pikave 2/a, 2/c dhe 3.

Për kërkesat që i drejtohen Sekretariatit, (sipas pikave 2/b dhe 3), para se të shqyrtohen për "miratim, në parim", paraprakisht, merret mendimi i KBU-ve përkatëse.

7. Përgatitja e dokumentacionit të tenderimit dhe procedura e tenderimit, deri në hartimin e listës së vlerësimit të propozimeve, kryhen nga:

- agjencia, pas miratimit, në parim, nga KBU-ja, për kërkesat e pikave 2/a dhe 3.
- Sekretaritati, pas miratimit, në parim, nga KKU-ja për kërkesat sipas pikave 2/c dhe 3 dhe nga vetë Sekretariati, për kërkesat sipas pikës 2/b.

8. Miratimin e listës së vlerësimit për koncesionet e kryejnë organet e përcaktuara në kolonat 6 dhe 7 të tabelave nr.1 dhe nr.2 të këtij vendimi.

9. Pas miratimit sipas pikës 8, Agjencia a Sekretariati dhe subjekti fitues (i klasifikuari i parë në listën e vlerësimit) nënshkruajnë një kontratë me kusht, si garanci për lidhjen e kontratës përkatëse.

10. Leja dhe autorizimi për përdorim rezervash ujore, në përfundim të procesit të tenderimit, miratohen nga:

- Këshilli i Basenit Ujëmbledhës (KBU), kur veprimtaria për të cilën kërkohet përdorimi i rezervës ujore parashikohet të kryhet brenda kufirit të basenit.
- Sekretariati, kur veprimtaria parashikohet të kryhet jashtë kufirit të një baseni të vetëm.
- Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU), kur veprimtaria, për të cilën kërkohet leja për përdorimin e rezervës ujore, është "lundrueshmëri" ose ndërtim strukturash, ankoruese dhe portuale".

Leja dhe autorizimi bëhen sipas formularëve tip, të miratuar nga KKU-ja.

11. Agjencia a Sekretariati ka të drejtë të njihet, të thërrasë për sqarim ose të verifikojë dokumentacionin e nevojshëm për besueshmërinë e subjektit kërkues.Barra e provës për të gjitha faktet e kërkuar apo veprimet kontrolluese gjatë procesit të tenderimit bie mbi subjektin kërkues.

12. Projektkontrata e koncesionit hartohet nga subjekti fitues i tenderit, duke u bazuar në termat e referencës së kontratës, pjesë përbërëse e dokumentacionit të tenderit, dhe negociiohet me Agjencinë a Sekretariatin, sipas kontratës me kusht. Kur projektkontrata është e pranueshme për të dyja palët, paraqitet për miratim, në mbledhjen e KKU-së ose KBU-së sipas rregulloreve përkatëse të tyre.

13. Organet, që kanë në përgjegjësi miratimin dhe ratifikimin e kontratës së koncesionit, jepen në tabelat nr.1 dhe nr.2 të këtij vendimi (kolonat 6,7,8 dhe 9).

14. Kontrata e koncesionit nënshkruhet nga kryetari i organit përkatës, sipas pikës 13, dhe nga përfaqësuesi ligjor i subjektit.

15. Kur brenda gjashtë muajve nga nënshkrimi i kontratës me kusht nuk arrihet të nënshkruhet kontrata e koncesionit, e pranueshme nga Agjencia a Sekretariati dhe subjekti fitues, ky i fundit humbet të drejtën e negociimit të mëtejshëm. Në këtë rast ftohet për negociim subjekti i klasifikuar i dytë, në listën e vlerësimit.

16. Afatet brenda të cilave subjekti që ka fituar të drejtën e përdorimit të një rezerve ujore duhet të fillojë veprimtarinë, janë:

- për autorizimet6 muaj
- për lejet12 muaj
- për koncesionetafati i shënuar në kontratë.

Pas këtij afati, subjekti humbet të drejtën e përdorimit të kësaj rezerve dhe kjo e drejtë i jepet, pas negociimeve, subjektit të klasifikuar i dyti, në listën e vlerësimit të tenderit.

17. Pranë Agjencisë dhe Sekretariatit, bazuar në regjimet e përdorimit të ujit, krijohen regjistra të veçantë, për:

- deklarimet për përdorim të lirë të ujit;

- autorizimet për kërkime, studime dhe zbulime në rezervat ujore, me përjashtim të kërkimit shkencor në fushën e peshkimit dhe aktuakulturës;

- lejet për përdorim rezervash ujore;

- koncesionet për përdorim rezervash ujore.

18. Të gjitha institucionet të japin dhe të rijapin lejet, që kanë në kompetencën dhe që i përkasin fushës së përdorimit të ujit, vetëm kur kërkuesi i tyre është i pajisur, nga autoriteti i ujit, me lejen (koncesionin) përkatëse.

19. Ngarkohet KKU-ja të hartojë formularët e kërkesës për përdorimin e rezervave ujore me leje, me autorizim dhe me koncesion, formularin tip të lejes e të autorizimit, si dhe kontratat e koncesionit (Tip) për rastet e pikës 5.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

KOMPETENCAT E AUTORITETEVE TË UJIT PËR MIRATIM KONCESIONESH
(NË FUNKSION TË QËLLIMIT TË PËRDORIMIT DHE TË SASISË SË UJIT)

TABELA NR.1
REZERVË UJORE PËR UJË TË PIJSHËM DHE TË KONFEKSIONUAR

Nr	Qëllimi i përdorimit	Njësi	Prurja		Autoriteti i ujit që miraton			Ratifikon Kuvendi	Organi ku aplikohet	
			>	<=	KBU	KKU	Këshilli i Ministrave		Agjenci e Ujit	Sek.Teki KKU
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1.	Për pirje	l/sek	0	100						
2.	Për konfeksionim	“	0	5						
3.	Për pirje	“	100	2000						
4.	Për konfeksionim	“	5	300						
5.	Për pirje	“	> 2000							

TABELA NR.2
REZERVË UJORE PËR UJITJE DHE HIDROENERGJI

Nr	Qëllimi i përdorimit	Njësi	Prurja		Autoriteti i ujit që miraton			Ratifikon Kuvendi	Organi ku aplikohet	
			>	<=	KBU	KKU	Këshilli i Ministrave		Agjensi e Ujit	Sek.Tek. i KKU
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11

1.			<=1							
2.	Ujë për ujitje dhe për hidroenergji	Min/ m3 në vit	1	5						
3.			5	10						
4.			10							

V E N D I M
Nr.69, datë 15.2.2001

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.321, DATË 5.7.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E SHPËRNDARJES SË FONDEVE, SIPAS RRETHEVE, PROCEDURAT E MIRATIMIT TË FAMILJEVE QË PËRFITOJNË DHE KUSHTET E DHËNIES SË KREDISË, NË KUADRIN E KREDISË GREKE PËR STREHIM"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8448, datë 25.1.1999, "Për ratifikimin e kredisë greke për programin e strehimit", me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pas pikës 1, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Diferencat në fonde që mund të rezultojnë, sipas ndarjes së përcaktuar në lidhjen nr.1, në blerje, do të përdoren nga Enti Kombëtar i Banesave po për blerje banesash në tregun e lirë, me miratimin e Ministrisë së Punëve Publike.".

2. Pas pikës 3 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Enti Kombëtar i Banesave, pas marrjes në dorëzim të apartamenteve, të ndërtuara ose të blera, i merr ato në pronësinë e vet dhe lidh me përfituesit kontratat e shitblerjes me kusht kreditimi.".

3. Pika 7, paragrafi i parë dhe dy kushtet e para të dhënies së kredisë ndryshohen si vijon:

"Familjet përfituese të kredisë marrin në dorëzim apartamentin nga Enti Kombëtar i Bensave vetëm pasi të kenë lidhur marrëveshjen e kredisë me Bankën e Kursimeve, si agjente e Qeverisë shqiptare për zbatimin e marrëveshjes së kredisë. Përfituesi i kredisë i nënshtrohet rregullave të Bankës së Kursimeve për shlyerjen e saj.

Kushtet e dhënies së kredisë janë:

- Afati i shlyerjes së kredisë 20 vjet.
- Interesi vjetor i kredisë është 7 për qind, në monedhën lek shqiptar.".

(Kushtet e tjera nuk ndryshojnë).

4. Pas pikës 7, shtohet pika 7/1 me këtë përmbajtje:

"7/1. Familjet që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën e mësipërme, nuk gëzojnë të drejtën e përfitimit të banesës.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 70, datë 15.2.2001

PËR STATUSIN E SPITALEVE UNIVERSITARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3 dhe 4 të ligjit nr.3766, datë 17.12.1963 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 5 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, Instituti i Ftiziopneumologjisë dhe Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik janë qendra kombëtare të mjekimit, të arsimit dhe të kërkimit në bashkëpunim me Fakultetin e Mjekësisë së Universitetit të Tiranës dhe kryejnë gjithashtu shërbimin spitalor sekondar për Tiranën.

2. Drejtimi administrativ i spitaleve universitare është në varësi të Ministrirë së Shëndetësisë. Drejtimi institucional është në varësi të dyfishtë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si organe që bashkërendojnë veprimtarinë e spitaleve universitare. Ministria e Shëndetësisë kryen kompesimin financiar për shërbimin që kryen stafi akademik i Fakultetit të Mjekësisë në spitalet universitare, sipas kontratave përkatëse.

3. Drejtorët e spitaleve universitare, nëse janë mjekë, emërohen nga rradhët e stafit akademik të Fakultetit të Mjekësisë.

4. Drejtori i përgjithshëm i Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, emërohet nga Kryeministri në bazë të propozimit të Ministrisë së Shëndetësisë.

Drejtorët e Institutit të Ftiziopneumologjisë dhe të Spitalit Universitar Obstetrik-Gjinekologjik emërohen nga Ministri i Shëndetësisë.

5. Funksionet Mjekësore, mësimore dhe shkencore të spitaleve universitare realizohen nga strukturat përkatëse në nivel departamenti e shërbimi, në bashkëpunim me drejtorinë e spitaleve universitare.

6. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës për nxjerrjen e rregullores së funksionimit të spitaleve universitare dhe të udhëzimeve përkatëse.

7. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.72, datë 15.2.2001

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 50 të ligjit nr.7662, datë 19.1.1993, "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores së produkteve për mbrojtje të bimëve, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr.584, datë 6.12.1993, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së

pesticideve, që përdoren në bujqësi", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

U D H Ë Z I M
Nr.3, datë 15.2.2001

PËR MBIKËQYRJEN DHE KOLAUDIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT

Në mbështetje të nenti 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7,12 dhe 18, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

U D H Ë Z O N:

I.MBI MBIKËQYRJEN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT

1. Mbikëqyrja e punimeve bëhet për çdo projekt dhe ka për qëllim kontrollin e mbarëvajtjes të të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh dhe anën ekonomike të tij.

2. Mbikëqyrja e punimeve kryhet nga persona fizikë ose juridikë, të pajisur me licencën përkatëse. Kur objekti ka vlerë mbi 5 milionë lekë, mbikëqyrësi i punimeve caktohet në përputhje me pikat 2 dhe 3, të vendimit nr.335, datë 23.6.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat e prokurimit publik", ndërsa për objektet me vlerë më pak se 5 milionë lekë, mbikëqyrësi caktohet nga kryetari i entit prokurues.

Vlera e kërkuar nga subjekti konkurrues për mbikëqyrjen, duhet të përfshihet në tarifat e përcaktuara në përputhje me vendimin nr.444, datë 5.9.1994, të Këshillit të Ministrave, "Tarifat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të veprave të ndërrimit" sipas llojit të objekteve, fazave të ndryshme (projektim, zbatim,kolaudim etj), si dhe klasifikimit të ndërtimeve.

Në rastin e investitorëve privatë nuk është e detyrueshme përzgjedhja e mbikëqyrësit me prokurim. Emri i tij duhet të depozitohet së bashku me kërkesën për lejen e ndërtimit. Mbikëqyrësi i punimeve nuk duhet të jetë i lidhur, në asnjë mënyrë, me zbatimin e objektit, që do të drejtojë. Mbikëqyrësi i punimeve në objektet private paguhet sipas kontratës së lidhur me investitorin, pa kufizim në caktimin e nivelit të pagesës.

3. Mbikëqyrësi i punimeve dhe stafi i tij kontrakton me investitorin, duke përcaktuar detyrimet e ndërsjellta, kushtet e punës, shpërblimin etj. Mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni nga investitori për nënkontraktorët e mundshëm që zgjedh sipërmarrësi, në përputhje me kontratën e nënshkruar. Mbikëqyrësi, përveç shërbimeve të kontrollit për zbatimin e punimeve, ndjek edhe grafikun e punimeve.

4. Përpara fillimit të punimeve në objekt, organi përgjegjës i qeverisjes vendore, në juridiksionin e të cilit ndodhet zona ku kryhet ky ndërtim, si dhe dega e policisë së ndërtimit marrin dijeni për personat kryesorë, përgjegjës për ndërtimin e tij, nga zbatuesi i punimeve, në përputhje me nenin 9 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998.

Urbanistika ligjore dhe policia e ndërtimit kontrollojnë në praninë e mbikëqyrësit në objekt dhe detyrojnë emërimin e tij në rastet kur ky emërim (lidhje kontrate) anashkalohet nga investitori.

Personat kryesorë përjegjës për ndërtimin e objektit janë:

- investitori,
- sipërmarrësi,
- projektuesi,
- mbikëqyrësi i punimeve.

Për çdo objekt që ndërtohet, mbikëqyrësi mban dhe përgjigjet, për dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Vendimin e KRRT-së për sheshin ose lejen e ndërtimit dhe lejen origjinale të ndërtimit;

b) Projektzbatimin e firmosur nga projektuesit, nga bashkia ose nga këshilli i qarkut, sipas juridiksionit.

c) Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinierik të themeleve, të bazamenteve dhe të punimeve të maskuara.

ç) Dokumentacionin përkatës për të gjitha ndryshimet e mundshme që mund të jenë bërë në projekt gjatë ndërtimit të objektit, pa prekur kushtet e vëna në vendimin e KRRT-së.

d) Planorganizimin e punimeve.

Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë, periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë e vërtetësinë e dokumenteve që pasqyrohen në të.

5. Në çastin e fillimit të punimeve, mbikëqyrësi duhet të bëjë verifikimet paraprake, si më poshtë vijojnë:

a) Verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës, të licencave, të autorizimeve dhe të lejeve, të cilat, sipas dispozitave në fuqi, duhet të merren para fillimit të punimeve.

b) Verifikimin e sheshit të ndërtimit, nëse është i lirë dhe i gatshëm për të filluar punimet.

c) Njohjen me hollësi të kontratës së sipërmarrjes dhe e të gjitha akteve administrative që lidhen me të, si dhe njohjen e të gjitha ndryshimeve të mundshme të kësaj kontrate me kalimin e kohës.

ç) Vendosjen e tabelës së identifikimit me të dhënat e mëposhtme:

- emërtimi i objektit;
- data e marrjes së lejes së ndërtimit;
- investitori;
- projektuesi;
- sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik;
- mbikëqyrësi;
- afati i ndërtimit;
- sipërfaqja e ndërtimit;
- lartësia (numri i kateve mbi dhe nën tokë);
- intensiteti sizmik i sheshit të ndërtimit, në bazë të studimit sizmiologjik dhe mikrozonimit sizmik.
- Për objektet mbi 8 kate të dhënat e studimeve inxhiniero-sizmologjike, të marra nga Instituti i Sizmologjisë.

6. Mbikëqyrësi i punimeve, pas verifikimeve të përcaktuara në pikën 9, harton dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Aktin e dorëzimit të sheshit të ndërtimit shoqërisë sipërmarrëse;

b) Aktin e dorëzimit nga sipërmarrësi të dokumentacionit, teknik dhe administrativ, si licenca, autorizime e leje të marra nga sipërmarrrësi.

c) Shkresën me atë të së cilës njofton pushtetin vendor për fillimin e punimeve.

7. Mbikëqyrësi i punimeve, gjatë zbatimit të objektit, i jep instruksione dhe urdhëra, me shkrim, sipërmarrësit sa herë që e sheh të nevojshme, në zbatim të akteve, ligjore e nënligjore dhe ky i fundit është i detyruar t'i respektojë ato, por duke ruajtur të drejtën t'i bëjë me shkrim investitorit vërejtjet e tij, për instruksionet dhe urdhrat e mbikëqyrësit të punimeve.

8. Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të propozojë largimin nga puna të një ose të disa personave nga personeli i sipërmarrësit. Për të realizuar këtë, ai i drejtohet me shkrim titullarit të shoqërisë sipërmarrëse, duke i shpjeguar arsyet. Arsyet kryesore të propozimit për largim mund të jenë moszbatimi i standardeve dhe i rregullave teknike, mosbindja, paaftësia, arbitrariteti në zgjidhjen e problemeve teknike ose pakujdesi të rënda.

9. Materialet që vijnë në kantier duhet të jenë në përputhje me kërkesat teknike të projektit. Materialet në vepër përdoren vetëm për miratimin e mbikëqyrësit të punimeve. Materialet e ardhura, si dhe pajisjet e siguruara nga sipërmarrësi, por që nuk pranohen nga mbikëqyrësi, zëvendësohen me të tjera, me shpenzimet e sipërmarrësit. Në këto raste (si për materialet, ashtu dhe për pajisjet) mospranimi duhet dokumentuar me procesverbalet e analizave të provave, së bashku me aktin teknik,

ku të argumentohen shmangiet e palejuara, referuar standardeve të detyrueshme shqiptare ose atyre europiane.

10. Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të kërkojë kryerjen e provave të materialeve të vendosura në objekt, kur këto nuk janë kryer në masën, sipas vëllimeve të realizuara dhe pjesës së lëndës së parë të furnizuar, për të verifikuar cilësinë. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarrësit.

11. Kur mbikëqyrësi i punimeve mendon se ka defekte në zbatimin e punimeve, kërkon verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë mbikëqyrësit të punimeve, shpenzimet janë në ngarkim të sipërmarrësit, në rast të kundërt, sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve.

12. Mbikëqyrësi ka të drejtë të pezullojë, përkohësisht, punimet për zbatimin teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, në çdo rast me miratimin e investitorit, për aq kohë sa quhet e nevojshme korrigjimi i gjendjes.

13. Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon zbatimin e grafikut të hollësishëm të punimeve dhe i raporton çdo muaj investitorit për realizimin e tij. Asnjë punim nuk do të mbulohet, maskohet a betonohet pa miratimin e mbikëqyrësit të punimeve. Sipërmarrësi duhet të njoftojë mbikëqyrësin kur punimet janë gati për t'u ekzaminuar prej tij.

14. E gjithë korrespondenca e mbikëqyrësit të punimeve me investitorin dhe me sipërmarrësin, përbën dokumentacionin e objektit dhe, si e tillë, ruhet me çdo kusht.

Mbikëqyrësi i punimeve mban dosjen e mbikëqyrjes së punimeve, ku pasqyrohen të gjitha aktet e mbajtura gjatë zbatimit të objektit, që nga akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, urdhrat e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të objektit, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike, të kërkuara ose të paraqitura gjatë zbatimit, si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjitha fazave të zbatimit të punimeve.

Në rastin e ndërrimit të mbikëqyrësit të punimeve, mbahet procesverbali i dorëzimit të dosjes së punimeve, ku shënohen edhe shkaqet e këtij ndërrimi. Dokumentacioni i mbikëqyrësit të vjetër i dorëzohet mbikëqyrësit të ri. Investitori mund të kërkojë largimin dhe zëvendësimin e mbikëqyrësit, kur vërtetohen mangësi serioze në veprimtarinë e tij, si:

- Mangësi në plotësimin e detyrave të përcaktuara në pikën 1 të këtij udhëzimi.
- Ndërprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre.
- Mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet, tolerim i materialeve me vlera mbi ato të preventivuara ose jo me cilësi.

15. Sipërmarrësi duhet t'i njoftojë me shkrim mbikëqyrësit të punimeve përfundimin e punimeve. Me këtë rast, brenda 30 ditëve, ai i parqet mbikëqyrësit:

a. Kontratën dhe aktet që lidhen me të.

b. Regjistrimin e kontabilitetit.

c. Procesverbalet e fillimit, të ndërprerjes ose të zgjatjes dhe të përfundimit të punimeve.

ç. Certifikatat e provave të materialeve të përdorura, të lëshuara nga laboratorët e autorizuar për këtë qëllim.

d. Deklaratë se objekti është ndërtuar në përputhje me projektin dhe me kushtet teknike.

Për të gjitha problemet e verifikuara prej tij, mbikëqyrësi i punimeve duhet të firmosë gjithçka që ka miratuar. Ai mban përgjegjësi ligjore, së bashku me sipërmarrësin. Një kopje e dokumentacionit, e miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve, i dërgohet kolaudatorit të objektit.

16. Mbikëqyrësi i punimeve merr pjesë në kolaudimin e veprës, i përgjigjet kolaudatorit me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për kolaudimin e veprës, si dhe firmos procesverbalin e këtij kolaudimi.

17. Situacionet e paraqitura nga sipërmarrësi, në fazat e ndryshme të punimeve kontrollohen dhe miratohen nga mbikëqyrësi i punimeve. Pagesa mund të kryhet vetëm në bazë të këtij miratimi. Këto dokumente dërgohen në sektorin financiar të punëdhënësit, bashkë me vërtetimin e përkohshëm të pagesës, për të shpallur vlerën e detyrueshme për pagim.

18. Pas përfundimit të kolaudimit, mbikëqyrësi i punimeve, mbështetur në kontratën dhe në dokumentacionin tjetër,përcakton vlerën përfundimtare të objektit, e cila i bëhet e ditur sipërmarrësit, si dhe i jepet për likujdim investitorit.

19. Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe autorizon përdorimin e fondit rezervë, të preventivuar, dhe i raporton, periodikisht, investitorit për gjendjen e tij. Ky i fundit, nëse ka vërejtje, e njofton sipërmarrësin dhe problemi zgjidhet ndërmjet tyre. Për çdo ndryshim të mundshëm, mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni, për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve në fjalë.

20. Kur vërehen shkelje të rënda të dispozitave ligjore, investitori ose dikasteri nga varet ky investitor, si dhe degët e policisë së ndërtimit, kanë të drejtë të urdhërojnë mbikëqyrësin e punimeve për ndërprerjen e punës, deri në marrjen e masave përkatëse, për normalizimin e gjendjes.

21. Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund të përbëjnë kundërvajtje administrative, vendosen sanksione, në bazë të neneve 15 dhe 16 të kreut III të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit".

II. PËR KOLAUDIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT

1. Kolaudimi i punimeve kryhet nga një specialist ose nga një grup specialistësh, ku secili duhet të ketë licencën përkatëse për specialitetin që mbulon në këtë kolaudim. Kolaudatori mund të jetë person, fizik ose juridik, vendas ose i huaj. Për objektet që ndërtohen me fonde publike, kolaudatori duhet të përzgjidhet nga punonjësit shtetëror, që plotësojnë kushtet e lartpërmendura dhe mundësisht të jetë në stafin e institucionit që shërben si ent prokurues. Pagesa e kolaudatorit bëhet nga investitori, në përputhje me vendimin nr.444, datë 5.9.1994, të Këshillit të Ministrave, "Për tarifat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit, sipas llojit të objekteve dhe klasifikimit të ndërtimeve.

2. Kolaudatori ose grupi i kolaudimit caktohet nga investitori, i cili duhet t'ia komunikojë, me shkrim, këtë person apo grup personash, Sekretariatit Teknik të KRRT-së, pranë zyrës dhe seksionit urbanistik përkatës në rreth, brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të punimeve.

Punëdhënësi duhet të përcaktojë, gjithashtu, në marrëveshje me mbikëqyrësin dhe kolaudatorin (ose grupin e kolaudimit), mënyrën dhe afatet e procesit të kolaudimit.

3. Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:

a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.

b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.

c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.

ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes.

4. Kur vërehen defekte në verifikimet që përcaktohen në pikën 3, kolaudatori ose grupi i kolaudimit lë detyra me shkrim për punimet që duhet të kryhen, duke përcaktuar afatet e përfundimit të tyre, në mënyrë që të plotësohen të gjitha kushtet e pikës 3. Në varësi nga natyra e këtyre defekteve përcaktohen detyrimet e secilës palë.

5. Përveç kolaudimit në fund të punimeve, është i detyrueshëm kolaudimi edhe gjatë procesit të punimeve, në rastet kur:

a. punimet janë komplekse dhe me vështirësi të veçanta;

b. në rastin e besimit të punimeve me koncesion.

6. Zhbllokimi i garancisë së kontratës 10 për qind të bëhet pasi të jetë përfunduar plotësisht kolaudimi i punimeve, ndërsa 5 për qind i garancisë së punimeve për periudhën pas kolaudimit zhbllokohet pas përfundimit të garancisë së objektit.

7. Në përfundim të kolaudimit të veprës, hartohet procesverbali i kolaudimit, i cili firmoset nga kolaudatori ose grupi i kolaudimit, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve. Proceverbali duhet të përmbajë:

a. vendin e ndërtimit;

b. emërtimin e objektit dhe funksionin e tij;

c. datën dhe prejardhjen e projekteve, si dhe ndryshimet e bëra në to;

ç. vlerën e objektit;

d. gjenealitetet e sipërmarrësit;

dh. afatin e ndërtimit;

e. vlerën e shpenzimeve (sipas regjistrave të kontabilitetit);

ë. gjenealitetet e kolaudatorit ose të grupit të kolaudimit dhe specialitetet përkatëse;

f. kohën e zgjatjes së kolaudimit;

g. përshkrimin e verifikimeve të bëra mbi dokumentet dhe faktin, si dhe rezultatet e arritura.

Procesverbali paraqitet në dy kopje, në zyrën e urbanistikës dhe, pas regjistrimit një kopje i dërgohet punëdhënësit.

III. Udhëzimi nr.4, datë 26.6.1995, i Këshillit të Ministrave, "Për drejtimin dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

U R D H Ë R
Nr.15, datë 9.2.2001

PËR KATEGORIZIMIN E DISA BASHKIVE, PËR EFEKT PAGE

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të vendimit nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore"

U R D H Ë R O J:

Miratimin e ndryshimit të kategorisë së bashkive si vijojnë:

a) Kalojnë në bashki të kategorisë së parë, bashkitë Kamëz, Pogradec, Patos, Sarandë, Kuçovë, Laç dhe Kukës.

b) Kalojnë në bashki të kategorisë së dytë, bashkitë Fushë-Krujë, Mamurras, Ballsh, Përmet, Çorovodë dhe Librazhd.

c) Kalojnë në bashki të kategorisë së tretë, bashkitë Klos, Himarë, Koplik, Tepelenë, Ersekë dhe Peqin.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

U D H Ë Z I M
Nr. 18 datë 11.03.2001

PËR MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË FORMULARËVE QË DO TË PËRDOREN PËR RISHIKIMIN E LISTAVE "A" TË ZGJEDHJEVE TË TETORIT 2000, NË ZYRAT E GJENDJES CIVILE

Në mbështetje të nenit 18 pika 2 të ligjit 8609 datë 08.05.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" , Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

Kundrejt një pagese shtesë, punonjësit e Zyrave të Gjendjes Civile (ZGJC) do të bëjnë rishikimin e listave "A" të zgjedhjeve të Tetorit 2000. Për rishikimin e këtyre listave punonjësit e ZGJC do të përdorin tre formularë:

Formulari nr. 1 (me ngjyrë jeshile)

Do të përdoret për të shtuar personat zgjedhës (që janë 18 vjeç e lart, deri në 17.06.20001) që kanë ardhur me banim në njësinë administrative që mbulon ZGJC, nga një njësi tjetër administrative,

për periudhën maj 2000 –25 mars 2001.

Mënyra e plotësimit të Formularit nr. 1

Sipas kërkesave që ka formulari, në hapësirat e lëna bosh nga punonjësi i ZGJC do të plotësohen:

Emri, p.sh.: AGRON, Atësia, p.sh.: HYSEN, Mbiemri, p.sh.: DASHI, Datëlindja, p.sh.: 12.10.1960, Gjinia, p.sh.: M, Emri i regjistrit, p.sh.: BARDHAJ, Nr. i regjistrit, p.sh.: 2, Faqe e regjistrit, p.sh.: 16.

Adresa aktuale, Rruga p.sh.: HOXHA TASIM, Godina, p.sh.: 10, Ap, p.sh.: 8.

Ardhur nga (B) ose (K) p.sh.: BASHKIA RRËSHEN, Nr. ZGJC, p.sh.: 20, Reg. Em, p.sh.: (LAGJJA E RE) Nr., p.sh.: 15, faqe, p.sh.: 24.

Formularët Nr. 1 të plotësuar në këtë mënyrë nga ZGJC-JA do të kalohen në bashki/komunë, njësi bashkiake dhe kryetari si dhe sekretari i këshillit të bAshkisë ose komunës (njësisë bashkiake) do të plotësojnë (duke u nisur nga adresa e personit) Nr. e qendrës së votimit QV (p.sh.2, kolona e fundit e këtij formulari), e këtyre personave.

Koha e plotësimit dhe e dorëzimit të formularit NR.1:14-27 Mars, 2001

Formulari Nr. 2 (me ngjyrë të verdhë)

Do të përdoret për të shtuar emrat e zgjedhësve që paraqiten në ZGJC me dokument identifikimi (letërnjoftimi, pasaportë për jashtë shtetit, Certifikatë me fotografi) dhe që paraqesin një ankesë me shkrim që ata nuk janë përfshirë në listat e zgjedhësve të zgjedhjeve të mëparshme.

Mënyra e plotësimit të formularit

Kur një person paraqitet me dokument identifikimi (letërnjoftim, pasaportë për jashtë shtetit, Certifikatë me fotografi) dhe paraqet një ankesë me shkrim që ai nuk është përfshirë në listat e zgjedhësve të QV të zgjedhjeve të mëparshme punonjësi i ZGJC-së verifikon nëse emri i tij është në formularin nr.3. Kur emri i tij nuk është në Formularin nr.3, ai verifikon nëse ky emër është në regjistrat e ZGJC. Kur emri i tij është në regjistrat e ZGJC-së, ai plotëson Formularin nr.2, me të dhënat e këtij zgjedhësi, që për nga mënyra e plotësimit është i njëjtë me atë të Formularit nr.1 (në Formularin nr.2 nuk përfshihet regjistrimi se nga ka ardhur personi). Kur personi nuk është i regjistruar në ZGJC, ai nuk shënon në Formularin nr. 2

Formularët nr.2 të plotësuar në këtë mënyrë kalohen në zyrat e bashkisë/komunës, njësisë bashkiake dhe kryetari si dhe sekretari i këshillit të bashkisë /komunës, njësia bashkiake do të plotësojnë (duke u nisur nga adresat e personave) nr. e Qendrës së Votimit të këtyre personave.

Koha e plotësimit dhe e dorëzimit të formularit: 14 mars – 7 prill 2001.

Formulari nr.3 (me ngjyrë të bardhë)

Do të përdoret për të përcaktuar personat zgjedhës që janë larguar me banim nga ajo njësi administrative në një njësi tjetër administrative, personat që kanë vdekur, ata që kanë ndërruar shtetësinë nga shqiptare në një shtetësi tjetër, për të korrigjuar gabimet ortografike të emrit, atësisë, mbiemrit, të datëlindjes si edhe gjinisë të zgjedhësve që ndodhen në formularin nr.3 (listën A të zgjedhësve).

Mënyra e plotësimit të formularit

Nëpunësi i ZGJC-së për zgjedhësit që ndodhen në Formularin nr.3 dhe që në regjistrin e ZGJC-së figurojnë të çregjistruar, në kolonën e fundit të formularit, shënojnë germën “L”.

Për zgjedhësit që ndodhen në Formularin nr.3 dhe që në regjistrin e ZGJC-së figurojnë të vdekur, në kolonën e fundit të formularit, shënojnë gërmën “D”.

Për zgjedhësit që ndodhen në Formularin nr.3 dhe që në regjistrin e ZGJC-së figurojnë që kanë ndërruar shtetësinë nga shqiptare në një shtetësi tjetër, në kolonën e fundit të formularit , shënojnë gërmën “S”.

Nënpunësi i Gjendjes Civile për çdo zgjedhës të përfshirë në Formularin nr.3, në bazë të emrit të regjistrit dhe numrit të faqes së tij do të kontrollojë nëse emri, atësia, mbiemri, datëlindja dhe gjinia e zgjedhësit janë shkruar pa gabime.

N.q.s. ato janë shkruar me gabime atëherë në hapësirën boshe poshtë tyre, shkruhet emri, atesia, mbiemri, datëlindja apo gjinia e sakte e zgjedhësit.

Koha e plotësimit të formularit: 27 mars – 7 prill 2001

Shënim: Plotësimi i formularëve do të bëhet vetëm me germa kapitale dhe me stilolaps me ngjyrë të kuqe.

Shënim: Formulari nr.1 dhe nr. 2 firmosen faqe për faqe nga përgjegjësi i ZGJC-së dhe sekretari i këshillit të bashkisë /komunës apo njësisë bashkiake, kurse shkresa përcjellëse e këtyre formularëve do të firmoset nga kryetari i bashkisë/komunës, njësisë bashkiake.

Formulari nr.3 firmoset faqe për faqe nga përgjegjësi i ZGJC-së dhe nga një punonjës tjetër i ZGJC-së. Shkresa përcjellëse që shoqëron Formularët nr.3 do të firmoset nga kryetari i bashkisë /komunës ose njësisë bashkiake.

Shënim: Plotësimi dhe dorëzimi i formularëve do të bëhet detyrimisht në afatet respektive të përcaktuara më lart.

KRYETARI
Ilirian Celibashi

NDREQJE GABIMESH

1. Ligji nr.8549 datë 11.11.1999 "Për statusin e nëpunësit civil" është dekretuar me dekretin nr.2496, datë 9.12.1999 të Presidentit të Republikës Rexhep Meidani.

2. Në Fletoren Zyrtare nr.6/1 Rregullorja e Burgjeve në përmbajtje, është:

"miratuar me vendimin nr.63, datë 9.3.2000"

Bëhet:

"miratuar me vendimin nr.96, datë 9.3.2000."

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.375, datë 14.7.2000 "Për disa ndryshime në vendimin nr.437, datë 3.9.1993, të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të Tatimeve"është botuar për herë të parë në Fletoren Zyrtare nr.22 të vitit 2000, për pasojë data e daljes nga shtypi e kësaj Fletore do të konsiderohet si data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi.

4. Në Fletoren Zyrtare nr.29 në faqen 1 të përmbajtjes, titulli i vendimit të KM nr.489, datë 19.9.2000, të bëhet "Për miratimin e procedurës së tenderimit, për shitjen e paketës së aksioneve, prej 88 për qind, të zotëruara nga shteti, në "Prodhime farmaceutike", sh.a, Tiranë, dhe shpall fitues të tenderit "Aldosch" sh.p.k.

Titulli i vendimit të KM nr.490, datë 19.9.2000, të bëhet "Për miratimin e procedurës së tenderimit, për shitjen e paketës së aksioneve, gjithsej 76 për qind, të zotëruara nga shteti, në "Kantina e Pijeve"Gjergj Kastrioti Skënderbeu"", sh.a, Durrës, dhe shpalljen fitues të tenderit "Rilindja", sh.p.k.

Titulli i vendimit të KM nr.491, datë 19.9.2000, të bëhet "Për miratimin e procedurës së tenderimit, për shitjen e paketës së aksioneve, gjithsej 94 për qind, të zotëruara nga shteti, në "Birra Malto", sh.a, Tiranë, dhe shpalljen fitues të tenderit të "Birra Peroni Industriale", Spa.

Titulli i vendimit të KM nr.492, datë 19.9.2000, të bëhet "Për miratimin e procedurës së tenderimit, për shitjen e paketës së aksioneve (90 për qind), të zotëruara nga shteti në "Qumështi Ajka, sh.a Tiranë, dhe shpalljen fitues të tenderit të "Aldosch" sh.p.k.

5. Në Fletoren Zyrtare Ekstra Gusht 2000, në brendësi, në faqen 201 për arsye teknike, mungon titulli i vendimit.

bëhet: Vendim i KM, nr.265, datë 3.6.1999 "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 22.4.1999 "Për rritjen e pagave të punonjësve të institucioneve buxhetore".

Në Fletoren Zyrtare Ekstra Gusht 2000, në përmbajtje, vendimet e Gjykatës së Lartë kanë këto numra:

Vendim 354 me objekt: "Dezertim dhe shpërdorim armatimi nenet 94/2 dhe 62/2 të Kodit të Procedurës Civile .

Vendim nr.46 i Gjykatës së Lartë me objekt: Vjedhje me dhunë neni 139 Kodit Penal.

Vendim nr.30 i Gjykatës së Lartë me objekt: Vrasje me dashje, në tentativë dhe armëmbajtje pa leje. Nenet 76, 76-22, dhe 278/2 të Kodit Penal.

Vendim 47 i Gjykatës së Lartë me objekt: Vrasje me dashje neni 83 i Kodit Penal.

6. Në Fletoren Zyrtare nr.15 ligji "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" ka numrin 8599, datë 1.6.2000.

Fletorja Zyrtare gjendet në:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 22.3.2001
Doli nga shtypi më 23.3.2001

Tirazhi: 4100 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "At Gjergj Fishta", Tiranë

Çmimi: 150 lekë